

**KONVENTA PËR MBROJTJEN E SPECIEVE SHTEGTUESE TË
KAFSHEVE TË EGRA**
(Konventa e Bonit)

PALËT KONTRAKTUESE,

DUKE KUJTUAR që kafshët e egra në format e tyre të shumta janë një pjesë e pazëvendësueshme e sistemit natyror të tokës që duhet të mbrohet për të mirën e njeriut;

TË NDERGJEGJSHEM që çdo gjeneratë e njerëzimit të ruajë resurset e tokës për gjeneratat e ardhshme dhe ka obligimin të sigurojë që kjo pasuri të mbrohet dhe, aty ku përdoret, përdoret gjerësisht;

KOSHIENTE për vlerën gjithnjë në rritje të kafshëve të egra nga këndvështrimi mjedisor, ekologjik, gjenetik, shkencor, estetik, çlodhës, kulturor, edukativ, social dhe ekonomik;

TË VEMENDSHEM veçanërisht për ato specie të kafshëve të egra që shtegtojnë përmes ose jashtë kufijve kombëtar;

DUKE KUJTUAR që Shtetet janë dhe duhet të jenë mbrojtësit e specieve shtegtuese të kafshëve të egra që jetojnë brenda ose kalojnë në kufijtë kombëtar,

TË QARTE që mbrojtja dhe menaxhimi efektiv i specieve shtegtuese të kafshëve të egra kërkon veprime të caktuara nga të gjitha Shtetet brenda kufijve kombëtarë në të cilin këto specie kalojnë pjesë të ciklit të tyre jetësor,

RIKUJTUAR Rekomandimin 32 të Planit të Veprimit miratuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin Njerëzor (Stokholm, 1972) dhe përmendur në Sesionin e Njëzetë e Shtatë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

RANE DAKORT si vijon:

Neni I

Interpretimi

Për qëllimin e kësaj Konventë:

a) "Specie shtegtuese" do të thotë gjithë popullata ose ndonjë pjesë e ndarë gjeografikisht e popullatës së një specieje ose taksoni më të ulët të kafshëve të egra, një proporcion sinjifikant i të cilëve në mënyrë rrethore dhe të parashikueshme kalon një ose më shumë kufij në juridiksion kombëtar;

b) "Status mbrojtës i specieve shtegtuese" do të thotë grupi i ndikimeve që veprojnë mbi speciet shtegtuese që ndikojnë mbi shpërndarjen dhe jetesën e tyre në të ardhmen;

c) "Statusi i mbrojtjes" do të merret si i favorshëm kur:

(1) të dhënat për dinamikën e popullatës tregojnë që speciet shtegtuese po ruajnë vetveten, mbi baza afatgjata, si një komponent të ndryshueshëm të ekosistemeve të tyre;

(2) brezi i specieve shtegtuese as nuk është reduktuar, as nuk do të reduktohet në të ardhmen;

(3) ka, dhe do të ketë në të ardhmen, vendbanim të mjaftueshëm për të mbajtur popullsinë e specieve shtegtuese në të ardhmen; dhe

(4) shpërndarja dhe sasia e specieve shtegtuese arrin sipërfaqe dhe nivele historikisht në përmasat që potencialisht ekzistojnë ekosisteme të përshtatshme dhe në përputhje me menaxhimin e gjerë të kafshëve të egra;

d) "Statusi i mbrojtjes" do të kuptohet si "i pafavorshëm" nëse ndonjë prej kushteve të caktuara në pikën (c) nuk plotësohet,

e) "I rrezikuar" në lidhje me një specie shtegtare të veçantë do të thotë që specia shtegtare është në rrezik zhdukje në të gjithë ose në një masë të mjaftueshme të popullatës së saj;

f) "Sipërfaqe" kuptohen të gjitha zonat me tokë ose ujë që një specie shtegtare popullon, qëndron përkohësisht, kalon ose fluturon në çdo kohë në rrugën normale të shtegtimit;

g) "Vendbanim" kuptohet çdo zonë në sipërfaqen e një specie shtegtuese që përmban kushte jetese të përshtatshme për atë specie,

h) "Shtet pjesëmarrës" në lidhje me një specie të veçantë shtegtuese kuptohet çdo Shtet (dhe aty ku është e mundur ndonjë palë sipas pikës (k) të këtij paragrafi) që ushtron juridiksion mbi një pjesë të sipërfaqes së kësaj specieve shtegtuese, ose një Shtet, kufijtë e të cilit shtrihen dhe jashtë kufijve kombëtarë të shtrirjes së asaj specie shtegtare;

i) "Kapje" kuptohet kapja, gjuajtja, peshkimi, zënia, shqetësimi, vrasja me qëllim ose përpjekja për të kryer një veprim të tillë;

j) "Marrëveshje" kuptohet një marrëveshje ndërkombëtare për mbrojtjen e një ose më shumë specieve shtegtuese siç thuhet në nenet IV dhe V të kësaj Konvente;

k) "Palë" kuptohet një Shtet ose çdo organizatë për integrimin ekonomik rajonal caktuar nga Shtetet që ka kompetenca në lidhje me bisedimin, konkluzionin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për çështjet që mbulon kjo Konventë për të cilat ajo është

në fuqi.

2. Brenda kompetencave të tyre, organizatat për integrimin ekonomik rajonal që janë Palë në këtë Konventë duhet që në emër të tyre të ushtrojnë të drejtat dhe përbushin përgjegjësitë që kjo Konventë cakton për Shtetet e tyre anëtare. Në të tilla raste Shteteve anëtare të këtyre organizatave nuk do t'u jepet e drejta të ushtrojnë këto të drejta individualisht.

3. Kur kjo Konventë kërkon që një vendim do të merret ose nga 2/3 ose nga të gjitha "Palët prezent ose që votojnë" kjo do të thotë "Palët që janë prezente dhe japin një votë pozitive ose negative". Ata që abstenojnë votimin nuk do të numërohen në "Palët që janë prezent dhe votojnë" për përcaktimin e shumicës.

Neni II

Principet Bazë

1. Palët njohin rëndësinë e specieve shtegtuese që duhen mbrojtur dhe Shtetet Pjesëmarrëse që bien dakort për të vepruar ku është e mundur dhe e përshtatshme, duke i kushtuar vëmendje të veçantë specieve shtegtuese gjendja e mbrojtjes e të cilave është e pafavorshme, dhe marrja individualisht ose në bashkëveprim e hapave të përshtatshëm dhe të nevojshëm për të mbrojtur këto specie dhe vendbanimet e tyre.

2. Palët njohin nevojën për të ndërmarre veprime për të shmangur atë që, një specie shtegtuese të bëhet e rrezikuar.

3. Në veçanti, Palët:

a) duhet të nxisin, bashkëpunojnë dhe mbështesin kërkimet për speciet shtegtuese;

b) do të përpiqen të sigurojnë mbrojtje të menjëhershme për speciet shtegtuese të përfshira në Shtojcën I; dhe

c) do të përpiqen të përfundojnë DOKUMENTE MIREKUPTIMI që përfshijnë mbrojtjen dhe menaxhimin e specieve shtegtuese të përfshira në Shtojcën II.

Neni III

Speciet Shtegtuese të Rrezikuara: Shtojca I

1. Shtojca I do të përmbajë speciet shtegtuese që janë të rrezikuara.

2. Një specie shtegtuese mund të vendoset në Shtojcën I kur është evidente, duke përfshirë dhe kërkimet shkencore, që tregojnë se ajo është e rrezikuar.

3. Një specie shtegtuese mund të hiqet nga Shtojca I kur Konferenca e Palëve përcakton që:

- a) është evidente, duke përfshirë dhe rezultatet e kërkimeve shkencore, që specia nuk është më e rrezikuar, dhe
- b) specia nuk duket se do të jetë përsëri e rrezikuar për arsye të humbjes së mbrojtjes prej lëvizjes nga Shtojca I.

4. Palët që janë Shtete Pjesëmarrëse të një specie shtegtuese të listuara në Shtojcën I duhet të përpiqen:

- a) të mbrojnë dhe, aty ku është e përshtatshme dhe e mundshme, riparimin e vendbanimeve të species që janë të rëndësishëm për shpetimin e species nga rreziku i zhdukjes,
- b) të parandalojnë, lëvizin, kompesojnë ose minimizojnë, sa të jetë e mundur, efektet e kundërta të aktiviteteve ose pengesat që ndalojnë seriozisht ose parandalojnë shtegtimin e specieve; dhe
- c) në masën paraprake dhe të përshtatshme, për të parandaluar, reduktuar ose kontrolluar faktorët që po rrezikojnë ose që duket se po rrezikojnë specien, përfshirë këtu kontrollin strikt të futjes, ose kontrollin ose eliminimin e specieve jo-vendase të përfshira.

5. Palët që janë Shtete Pjesëmarrëse të një specie shtegtuese të listuar në Shtojcën I duhet të ndalojnë kapjen e kafshëve që i takojnë këtyre specieve. Veçanti do të këtë për këtë ndalim vetëm nëse:

- a) kapja kryhet për qëllime shkencore;
- b) kapja kryhet me qëllim për të shtuar përhapjen ose mbijetesën e specieve të ndikuara;
- c) kapja kryhet për të rregulluar nevojat e përdorimeve tradicionale të jetesës të këtyre specieve; ose
- d) nëse rrethana të veçanta e kërkojnë kështu;

duke siguruar që veçanti të tilla janë preçize në përmajtje dhe me limit në hapësirë dhe kohë. Këto kapje nuk duhet të kryhen në disavantazh të species.

6. Konferenca e Palëve mund të rekomandojë tek Palët që janë Shtete Pjesëmarrëse që për një specie shtegtuese të listuar në Shtojcën I ato të marrin masa të mëtejshme që konsiderohen të përshtatshme në dobi të species.

7. Palët duhet që sa më parë të informojnë Sekretariatin për ndonjë veçanti të bërë në përputhje me pikën 5 të këtij Neni.

Neni IV

Speciet Shtegtare që Janë Objekt i MIREKUPTIMEVE: Shtojca II

Shtojca II liston speciet shtegtare që kanë një status mbrojtjeje të pafavorshëm dhe që kërkon mirëkuptime ndërkombëtare për mbrojtjen dhe menaxhimin e tyre, si dhe ato që kanë një status mbrojtjeje dhe që mund të përfitojnë prej bashkëpunimit ndërkombëtar që mund të arrihet prej një mirëkuptimi po ndërkombëtar.

2. Nëse rrethanat janë të justifikuara, një specie shtegtuese mund të listohet në të dy Shtojcat.
3. Palët që janë Shtete pjesëmarrëse të specieve shtegtuese të listuara në Shtojcën II duhet të kryejnë MIREKUPTIME prej të cilave duhet të përfitojnë speciet dhe t'u jepet prioritet specieve në një mënyrë mbrojtjeje të papërshtatshme.
4. Palët janë të inkurajuar të ndërmarrin veprime me qëllim që të kryejnë mirëkuptimet për një popullatë ose pjesë gjeografikisht të ndarë të popullatës së species ose taksoni më të ulët të kafshës së egër, anëtarët e të cilit përiodikisht kryqëzojnë një ose më shumë kufij kombëtarë.
5. Sekretariati duhet të informohet me një kopje të çdo MIREKUPTIMI të arritur në përputhje me kushtet e këtij Neni.

Neni V

Udhëzime për MIREKUPTIMET

1. Objekt i çdo MIREKUPTIMI do të jetë rivendosja e specieve shtegtare në fjalë në një gjendje mbrojtjeje të favorshme ose ta mbajë atë në një status të tillë. Çdo MIREKUPTIM duhet të lidhet me ato aspekte të mbrojtjes dhe menaxhimit të specieve shtegtuese në fjalë që i shërbejnë arritjes së objektivit.
2. Çdo MIREKUPTIM duhet të mbulojë të gjithë sipërfaqen e specieve shtegtuese në fjalë dhe duhet të jetë i hapur për pjesëmarrje për të gjitha Shtetet Pjesëmarrëse të atyre specieve, që janë ose jo Palë në këtë Konventë.
3. Një MIREKUPTIM duhet, aty ku është e mundur, të përmbajë më shumë se një specie shtegtuese.
4. Çdo MIREKUPTIM duhet:
 - a) të identifikojë speciet shtegtare që përfshin;

b) të përshkruajë sipërfaqen dhe rrugën e shtegimit të species;

c) të sigurojë për çdo Palë që të caktojë autoritetin kombëtar që lidhet me zbatimin e MIREKUPTIMIT;

d) të vendosi, nëse është e nevojshme, mekanizmat e përshtatshëm për të plotësuar qëllimet e MIREKUPTIMIT, të vëzhgojë efektivitetin e tij, dhe të përgatisë raporte për Konferencën e Palëve;

e) të sigurojë procedura për zgjidhjen e konflikteve midis Palëve në MIREKUPTIM: dhe

f) në minimum, të ndalojë, në lidhje me një specie shtegtare të Gjitarëve të Detit, ndonjë kapje që nuk është e lejuar për atë specie shtegtuese sipas ndonjë mirëkuptimi tjetër shumëpalësh dhe të sigurojë pranimin e MIREKUPTIMIT prej Shteteve që nuk janë Pjesmarrëse të asaj specie shtegtuese.

5. Aty ku është e përshtatshme dhe e mundshme, çdo MIREKUPTIM duhet të sigurojë, por të mos kufizohet në:

a) konstatimin periodik të gjendjes së mbrojtjes së species shtegtuese në fjalë dhe identifikimin e faktorëve që mund të rrezikojnë atë gjendje;

b) plane të koordinuara mbrojtjeje dhe menaxhimi;

c) kërkime për ekologjinë dhe dinamikën e popullatës së species shtegtuese në fjalë, duke i kushtuar vëmendje shtegimit;

d) shkëmbimi i informacionit për specien shtegtuese në fjalë, vëmendje e veçantë kushtuar shkëmbimit të rezultateve të kërkimit dhe statistikave përkatëse;

e) mbrojtja dhe, kur kërkohet dhe është e mundur, përmirësimi i vendbanimeve të rëndësishëm për mbajtjen e një gjendje mbrojtjeje të favorshme, dhe mbrojtja e këtyre vendbanimeve nga shqetësimet, përfshirë këtu kontrollin strikt të futjes, ose kontrollin. e specieve jo-vendase të futura që dëmtojnë speciet shtegtuese;

f) mbajtja e një rrjeti të përshtatshëm të vendbanimeve në lidhje me rrugët shtegtuese;

g) aty ku shfaqet e dëshirueshme, parashikimi i vendbanimeve të reja të favorshme për specien shtegtuese ose ri-futjen e specieve shtegtuese në vendbanime të favorshme;

h) eliminimi në maksimumin e mundshëm, ose kompensimi për aktivitetet dhe pengesat që vonojnë ose ndalojnë shtegtimin;

i) parandalimi, reduktimi ose kontrolli i lëshimit të substancave të dëmshme në vendbanimin e species shtegtuese për atë specie;

j) masat e bazuara në principet ekologjike për të kontrolluar dhe menaxhuar kapjen e species shtegtuese;

k) procedurat për koordinimin e veprimeve për të ndaluar veprimet ilegale;

l) shkëmbimi i informacionit për rreziqet kryesore ndaj species shtegtuese.

m) procedurat emergjente nëpërmjet të cilave veprimi mbrojtës do të forcohet në mënyrë të konsiderueshme dhe të shpejtë kur statusi i mbrojtjes i species shtegtuese është ndikuar seriozisht. dhe

n) bërja e publikut të gjerë të ndërgjyegjshëm për përmbajtjen dhe qëllimet e MIREKUPTIMIT.

Neni VI

Shtetet Pjesmarrëse

1. Një listë e Shteteve Pjesmarrëse të specieve shtegtuese të listuara në Shtojcat I dhe II do të mbahet nga Sekretariati duke përdorur informacionin e marrë nga Palët.

2. Palët duhet të mbajnë Sekretariatit të informuar se për cilat nga speciet shtegtuese të listuara në Shtojcat I dhe II ato e konsiderojnë veten Shtete Pjesëmarrëse, duke përfshirë dhe informacionin në territoret jashtë kufijve kombëtarë në kapjen e specieve shtegtuese në fjalë dhe, ku është e mundur, planet e ardhshme lidhur me kapje të tilla.

3. Palët që janë Shtete Pjesmarrëse për speciet shtegtuese të listuara në Shtojcat I ose II duhet të informojnë Konferencën e Palëve nëpërmjet Sekretariatit, të paktën 6 muaj para çdo takimi të zakonshëm mbi masat që janë marre për të zbatuar kushtet e kësaj Konvente për ato specie.

Neni VII

Konferenca e Palëve

1. Konferenca e Palëve është organi vendim-marrës i kësaj Konvente.

2. Sekretariati do të organizojë takimin e Konferencës së Palëve jo më vonë se dy vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

3. Gjithashtu Sekretariati do të organizojë takime të Konferencës së Palëve në një interval jo më shumë se një herë në tre vjet, pavarësisht se Konferenca vendos ndryshe, dhe takime të jashtëzakonshme në çdo kohë pas kërkesës me shkrim e të paktën 1/3 së Palëve.

4. Konferenca e Palëve do të krijojë dhe mbajë nën kontroll rregullat financiare të Konventës. Konferenca e Palëve duhet, në çdo takim të zakonshëm të miratojë buxhetin për periudhën tjetër financiare. Çdo Palë duhet të kontribuojë në buxhet sipas një shkalle që do të miratohet nga Konferenca. Rregullat financiare, përfshirë këtu parashikimin e buxhetit dhe shkallën e kontributeve si dhe modifikimet e tyre, duhet të miratohen me votim të hapur nga Palët prezent dhe që votojnë.

5. Në çdo takim Konferenca e Palëve do të marrë në shqyrtim zbatimin e Konventës dhe në veçanti:

a) do të shikojë dhe vlerësojë statusin e mbrojtjes së specieve shtegtuese;

b) shikojë progresin e bërë drejt mbrojtjes së specieve shtegtare, veçanërisht të atyre të listuara në Shtojcat I dhe II;

c) të bëjë një parashikimin dhe të sigurojë udhëzime që mund të jenë të nevojshme për të ndihmuar Këshillin Shkencor dhe Sekretariatin të kryejnë detyrat e ngarkuara;

d) të marrë dhe konsiderojë raportet e paraqitura nga Këshilli Shkencor, Sekretariati, ndonjë Palë ose organizëm i krijuar për një MIREKUPTIM;

e) të bëjë rekomandime tek Palët për përmirësimin e statusit të mbrojtjes të specieve shtegtuese dhe të shikojë progresin e arritur sipas MIREKUPTIMIT;

f) në rastet kur një MIREKUPTIM nuk është përfunduar, bën rekomandime për mbajtjen e takimeve të Palëve që janë Shtete Pjesëmarrëse të një specie shtegtuese ose një grupi të tyre për të diskutuar masat për të përmirësuar statusin e mbrojtjes së tyre;

g) bëjë rekomandime Palëve për përmirësimin e efektivitetit të kësaj Konvente; dhe

h) vendosi për ndonjë masë shtesë që duhet të merret për të zbatuar objektivat e Konventës.

6. Çdo takim i Konferencës së Palëve duhet të caktojë datën dhe vendin e takimit tjetër.

7. Çdo takim i Konferencës së Palëve duhet të përcaktojë dhe miratojë rregulla për procedurat për atë takim. Vendimet në një takim të Konferencës së Palëve kërkojnë 2/3 e shumicës së Palëve prezent dhe që votojnë, përveç se kur thuhet ndryshe në këtë Konventë.

8. Kombet e Bashkuara, Agjencitë e saj të Specializuara, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, si dhe ndonjë Shtet që nuk është Palë në këtë Konventë dhe për çdo MIREKUPTIM, organizmi i caktuar nga palët për atë MIREKUPTIM, mund të përfaqësohet si vëzhgues në takimin e Konferencës së Palëve.

9. Ndonjë agjenci ose organizëm teknikisht i kualifikuar në mbrojtjen dhe menaxhimin e specieve shtegtuese, sipas kategorive të mëposhtme, që ka njoftuar Sekretariatit për dëshirën e pjesëmarrjes në takimet e Konferencës së Palëve si vëzhgues, do të pranohet pavarësisht nëse 1/3 e Palëve shpreh mosaprovim;

a) agjencitë ose organizmat ndërkombëtare, qeveritare ose jo-qeveritare, dhe agjencitë e organizmat qeveritare kombëtare; dhe

b) agjencitë ose organizmat kombëtare jo-qeveritare që janë miratuar për këtë qëllim nga Shteti ku ato veprojnë.

Pas pranimit, këto vëzhgues kanë të drejtën të marrin pjesë por pa të drejtë vote.

Neni VIII

Këshilli Shkencor

1. Në takimin e parë, Konferenca e Palëve do të krijojë një Këshill Shkencor për të marrë këshilla në aspektin shkencor.

2. Çdo Palë mund, të caktojë një ekspert të kualifikuar si anëtar të Këshillit shkencor. Gjithashtu, Këshilli Shkencor do të ketë në përbërje dhe ekspertë të kualifikuar, të zgjedhur dhe caktuar nga Konferenca e Palëve; numri i këtyre ekspertëve, kriteret për zgjedhjen e tyre dhe kushtet për caktimin e tyre do të caktohen nga Konferenca e Palëve.

3. Këshilli Shkencor do të mbledhet me kërkesë të Sekretariatit pasi kërkohet nga Konferenca e Palëve.

4. Me aprovim të Konferencës së Palëve, Këshilli Shkencor do të vendosë rregullat e tij të punës.

5. Konferenca e Palëve do të përcaktojë funksionet e Këshillit Shkencor, që përfshin:

a) sigurimin e këshillimit shkencor për Konferencën e Palëve për Sekretariatit dhe nëse miratohet nga Konferenca e Palëve, për çdo organizëm të krijuar sipas Konventës ose një MIREKUPTIMI ose për ndonjë Palë,

b) rekomandimet e kërkimit dhe koordinimi i kërkimeve për speciet shtegtuese, duke vlerësuar rezultatet e këtij kërkimi me qëllimin për të qartësuar gjendjen e mbrojtjes së specieve shtegtuese dhe raportimin në Konferencën e Palëve mbi këtë gjendje dhe masat për përmirësimin e tij;

c) rekomandime për Konferencën e Palëve për speciet shtegtuese që do të përfshihen në Shtojcat I dhe II, së bashku me përcaktimin e sipërfaqes së këtyre specieve;

d) rekomandime për Konferencën e Palëve për masa specifike për mbrojtjen dhe menaxhimin për tu përfshirë në MIREKUPTIME për speciet shtegtuese dhe

e) rekomandime për Konferencën e Palëve mbi zgjidhjet e problemeve që lidhen me aspektet shkencore të zbatimit të kësaj Konvente, në veçanti në lidhje me vendbanimet e specieve shtegtuese.

Neni IX

Sekretariati

1. Për qëllimet e kësaj Konvente një Sekretariat do të krijohet.

2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Sekretariati caktohet nga Drejtori Ekzekutues i Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin. Sipas kompetencave dhe kur ai e konsideron të përshtatshme, mund të ndihmohet nga agjenci dhe institucione ndërqeveritare ose jo-qeveritare, ndërkombëtare ose kombëtare të përshtatshme dhe teknikisht të kualifikuara për mbrojtjen dhe menaxhimin e kafshëve të egra.

3. Nëse Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin nuk mund të kryejë rolin e Sekretariatit, Konferenca e Palëve do të bëjë zgjedhje tjetër për Sekretariatin.

4. Funksionet e Sekretariatit do të jenë:

a) të përgatisë dhe drejtojë takimet e:

- i) Konferencës së Palëve dhe
- ii) të Këshillit Shkencor;

b) të mbajë lidhje dhe nxisë të tilla midis Palëve, sekretariateve të ndërmjetëm të krijuar për MIREKUPTIMET dhe organizatave të tjera ndërkombëtare të lidhura me speciet shtegtuese;

c) të marrë raporte nga burime të përshtatshme dhe informacion tjetër që do të plotësojnë objektivat dhe zbatimin e kësaj Konvente dhe të kryejë shpërndarjen e drejtë të këtij informacioni,

d) të tërheqi vëmendjen e Konferencës së Palëve për çështje që lidhen me objektivat e Konventës;

e) të përgatisi për Konferencën e Palëve raporte mbi punën e Sekretariatit dhe për zbatimin e Konventës;

f) të mbajë dhe publikojë një listë të Shteteve Pjesëmarrëse të të gjitha specieve shtegtuese të përfshira në Shtojcat I dhe II;

- g) të nxisë nën drejtimin e Konferencës së Palëve, realizimin e MIREKUPTIMEVE;
- h) të mbajë dhe bëjë të vlefshëm për Palët një listë të MIREKUPTIMEVE dhe nëse kërkohet nga Konferenca e Palëve, të sigurojë informacion mbi MIREKUPTIMET;
- i) të mbajë dhe publikojë një listë të rekomandimeve të bëra nga Konferenca e Palëve sipas pikave (e), (f), dhe (g) të pikës 5 të Nenit VII ose vendimeve të marra sipas pikës (h) të po asaj pikë;
- j) të sigurojë për publikun e gjerë informacion për Konventën dhe objektivat e saj; dhe
- k) të kryejë ndonjë funksion tjetër të caktuar atij sipas kësaj Konventë ose prej Konferencës së Palëve.

Neni X

Ndryshime të Konventës

1. Kjo Konventë mund të ndryshohet në çdo takim të zakonshëm ose jashtëzakonshëm të Konferencës së Palëve.
2. Propozime për ndryshime mund të bëhen nga çdo Palë.
3. Teksti i çdo ndryshimi të propozuar dhe arsyet për të do të komunikohen tek Sekretariati të paktën 150 ditë përpara takimit në të cilin ato do të merren në shqyrtim dhe menjëherë do të komunikohet prej Sekretariatit tek të gjitha Palët. Çdo koment mbi tekstin prej Palëve do të komunikohet tek Sekretariati jo më pak se 60 ditëve para fillimit të takimit. Sekretariati, pas ditës së fundit për dorëzimin e komenteve, do tu komunikojë Palëve të gjitha komentet e dorëzuara atë ditë.
4. Ndryshimet duhet të miratohen nga 2/3 e Palëve prezent dhe që votojnë.
5. Një ndryshim i miratuar do të hyjë në fuqi për të gjitha Palët që e kanë pranuar atë ditën e parë të muajit të tretë pas datës kur 2/3 e Palëve kanë depozituar instrumentin e pranimi tek Depozituesi. Për çdo Palë që depoziton një instrument pranimi pas datës kur 2/3 e Palëve kanë depozituar instrumentin e pranimi, ndryshimi do të hyjë në fuqi për atë Palë ditën e parë të muajit të tretë pas depozitimit të instrumentit të tij të pranimi.

Neni XI

Ndryshimi i Shtojcave

1. Shtojcat I dhe II mund të ndryshohen në çdo takim të zakonshëm ose jashtëzakonshëm të Konferencës së Palëve.

2. Propozimet për ndryshim mund të bëhen nga çdo Palë.
3. Teksti i çdo ndryshimi të propozuar dhe arsyet për të, bazuar në argumentimin shkencor më të mirë, do të komunikohen tek Sekretariati të paktën 150 ditë përpara takimit dhe do të komunikohen menjëherë prej Sekretariatit tek Palët. Çdo koment mbi tekstin prej Palëve do ti komunikohet Sekretariatit jo më pak se 60 ditë përpara takimit. Sekretariati, menjëherë pas ditës së fundit për pranimin e komenteve, do ti komunikojë Palëve të gjitha komentet e dorëzuara atë ditë.
4. Ndryshimet duhet të miratohen nga 2/3 e Palëve prezente dhe që votojnë.
5. Një ndryshim i Shtojcave do të hyjë në fuqi për të gjitha Palët 90 ditë pas takimit të Konferencës së Palëve në të cilën ai u miratua, përveç për ato Palë që paraqesin rezervë në përputhje me pikën 6 të këtij Neni.
6. Gjatë periudhës 90 ditëshe sipas pikës 5 të këtij Neni, çdo Palë nëpërmjet njoftimit të shkruar tek Depozituesi mund të paraqesi rezerva në lidhje me ndryshimin. Rezerva për një ndryshim mund të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi me shkrim tek Depozituesi dhe më pas ndryshimi do të hyjë në fuqi për atë Palë 90 ditë pasi rezerva është tërhequr.

Neni XII

Efekti mbi Konventat Ndërkombëtare dhe Legjislacion Tjetër

1. Kjo Konventë nuk mund të paragjykojë kodifikimin dhe zhvillimin e Ligjit të Detit prej Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit miratuar sipas Rezolutës 2750 C (XXV) të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe as vërejtjet e tashmë dhe të ardhme dhe pikpamjet ligjore të çdo Shteti lidhur me ligjin e detit ditë dhe natyrën e zgjatjen e vijës bregdetare dhe territoreve nën juridiksion jashtë Shtetit mëmë.
2. Kushtet e kësaj Konvente nuk do të ndikojnë në të drejtat ose detyrimet e çdo Pale që ndryshojnë nga ndonjë traktat, konventë ose mirëkuptim ekzistues.
3. Kushtet e kësaj Konvente nuk do të ndikojnë në të drejtën e Palëve për të zbatuar masa strikte për mbrojtjen e specieve shtegtuese të listuara në Shtojcat I dhe II ose të zbatojnë masa lidhur me mbrojtjen e specieve që nuk ndodhen në Shtojcat I dhe II.

Neni XIII

Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

1. Çdo mosmarrveshje që mund të lindë midis dy ose më shumë Palëve lidhur me interpretimin ose aprovimin e kushteve të kësaj Konvente do të jetë objekt i negociimit midis Palëve të përfshira në mosmarrëveshje.

2. Nëse mosmarrveshja nuk mund të zgjidhet sipas pikës 1 të këtij Neni, Palët me konsensus të përbashkët, mund të paraqesin mosmarrveshjen në gjyq, veçanërisht tek Trupi gjykues i Përhershëm i Hagës, dhe Palët që kanë paraqitur mosmarrveshjen duhet ti binden vendimit të marrë.

Neni XIV

Rezervat

1. Kushtet e kësaj Konvente nuk do të jenë objekt i rezervave të përgjithshme. Rezerva specifike mund të pranohen sipas kushteve të këtij Neni dhe Nenit XI.

2. Çdo Shtet ose çdo organizatë rajonale për integrimin ekonomik mund të, kur dorëzon instrumentin e ratifikimit, aprovimit, ose pranimit, paraqesë rezerva specifike lidhur me praninë në Shtojcën I ose II ose të dyja, të çdo specie shtegtuese dhe mund të mos bëhet Palë në lidhje me subjektin e rezervës deri 90 ditë pasi Depozituesi ka transmetuar tek Palët njoftimin që një rezervë e tillë është tërhequr.

Neni XV

Nënshkrimi

Kjo Konventë do të hapet për nënshkrim në Bon për të gjitha Shtetet dhe çdo organizatë rajonale për integrimin ekonomik deri në 22 Qershor 1980.

Neni XVI

Ratifikimi, Pranimi, Aprovimi

Kjo Konventë do të jetë objekt i ratifikimit, pranimit, ose aprovimin. Instrumentat e ratifikimit, pranimit ose aprovimit do të depozitohen tek Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë, e cila do të jetë Depozituesi.

Neni XVIII

Pranimi

Pas 22 Qershorit 1980 kjo Konventë do të jetë e hapur për pranim për të gjitha Shtetet që nuk e kanë nënshkruar dhe çdo organizatë rajonale për integrim ekonomik. Instrumentat e pranimit do të depozitohen tek Depozituesi.

Neni XVM

Hyrja në Fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pas datës së depozitimit të instrumentit të 15 të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose pëlqimit tek Depozituesi.

2. Për çdo, Shtet ose organizatë rajonale për integrimin ekonomik që ratifikon, pranon ose aprovon këtë Konventë ose pëlqen pas depozitimit të instrumentit të 15 të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose pëlqimit, kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pas depozitimit prej këtij Shteti ose organizatë për instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose pëlqimit.

Neni XIX

Denoncimi

Çdo Palë mund të denoncojë këtë Konventë nëpërmjet një njoftimi të shkruar tek Depozituesi në çdo kohë. Denoncimi do të bëhet efektiv 12 muaj pasi Depozituesi ka marrë njoftimin.

Neni XX

Depozituesi

1. Originali i kësaj Konventë në Anglisht, Frengjisht, Gjermanisht, Rusisht dhe ai Spanjisht, ku çdo version duhet të jetë i njëjtë, do të depozitohet tek Depozituesi. Depozituesi do të transmetojë kopje të noterizuara të çdo versionit tek të gjitha Shtetet dhe organizatat rajonale për integrimin ekonomik që kanë nënshkruar këtë Konventë ose depozituar instrumentat e pëlqimit për të.

2. Depozituesi, pas konsultimit me Qeveritë në fjalë, përgatit versionet zyrtare të tekstit të Konventës në Arabisht dhe gjuhën Kineze.

3. Depozituesi duhet të informojë të gjitha Shtetet dhe organizatat rajonale për integrimin ekonomik nënshkruese dhe pëlqyese si dhe Sekretariatit për nënshkrimin, depozitimin e instrumentave të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose pëlqimit, hyrjen në fuqi të kësaj Konvente, shtesat, rezervat specifike dhe njoftimin e denoncimit.

4. Sapo Konventa hyn në fuqi, një kopje e noterizuar do të dërgohet nga Depozituesi tek Sekretariati i Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim sipas Nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

NË PRANI nënshkruesit, të autorizuar për këtë, nënshkruan këtë Konventë.

Bon 23 Qershor 1979

Në emër të:

PINNIPEDIA

Phocidae *Monachus monachus**

PERISSODACTYLA

Equidae *Equus grevyi*

ARTIODACTYLA

Camelidae *Vicugna vicugna** (përveç popullatës së Perusë)²
2) Më pare njohur si *Lama vicugna** (përveç popullatës së Perusë)

Cervidae *Cervus elaphus barbarus*

Bovidae *Bos sauveli*
 Bos grunniens
 Addax nasomaculatus
 Gazelia cuvieri
 Gazella dama
 Gazella dorcas (vetëm në popullatat Afrikanore)
Veriperëndimore)
 Gazella leptoceros
 *Oryx dammah**

AVES

PROCELLARIIFORMES

Diomedidae *Diomedea albatrus*

Procellariidae *Pterodroma cahow*
 Pterodroma phaeopygia

PELECANTIFORMES

Pelecanidae *Pelecanus crispus* *
 Pelecanus onocrotalus * (vetëm në popullatat e
Palearktikut)

CICONIIFORMES

Ardeidae *Egretta eulophotes*
Ciconiidae *Ciconia boyciana*
Threskiornithidae *Geronticus eremita* *

ANSERIFORMES

Anatidae *Chloephaga rubidiceps* *
 Oxyura leucocephala *

FALCONIFORMES

Accipitridae *Haliaeetus albicilla* *
 Haliaeetus pëlagicus *

GRUIFORMES

Gruidae *Grus japonensis* *
 Grus leucogeranus *
 Grus nigricollis *

Otididae *Chlamydotis undulata* * (vetëm në popullatat e Afrikës
Veriperëndimore)

Otis tarda * (popullata të Evropës Qendrore)

CHARADRIIFORMES

Scolopacidae *Numenius borealis* *
 Numenius tenuirostris *

Laridae *Larus audouinii* *
 Larus leucophthalmus *
 Larus relictus

Alcidae *Larus saundërsi*
 Synthliboramphus wumizusume

PASSERIFORMES

Parulidae *Dendroica kirtlandii*
Fringillidae *Serinus syriacus*

REPTILIA

TESTUDINATA

Cheloniidae *Chelonia mydas* *
 Caretta caretta *
 Eretmochelys imbricata *
 Lepidochelys kempii *
 Lepidochelys olivacea *
Dermochelyidae *Dermochelys coriacea* *

Pelomedusidae
sipërme)

Pedocnemis expansa * (vetëm në popullatat e Amazonës së

CROCODYLIA

Gavialidae

Gavialis gangeticus

PISCES

SILURIFORMES

Schilbeidae

Pangasianodon gigas

SHTOJCA II

Interpretim

1. Speciet shtegtuese të përfshira në këtë Shtojcë janë listuar:

- a) sipas emrit të species ose nën-species; ose
- b) të qëna të gjitha specie shtegtuese të përfshira në një takson më të lartë ose pjesë e caktuar specia, dhe nëse thuhet ndryshe, ku i është referuar një taksoni më të lartë se specia, kuptohet që të gjitha speciet shtegtuese brenda atij taksoni duhet të përfitojnë nga përgatitja e MIREKUPTIMIT.

Shkurtimi “spp” pas emrit të një Familje ose Gjinie është përdorur për të treguar të gjitha speciet shtegtuese brenda asaj Familje ose Gjinie.

Referenca të tjera për taksonë më të larta se specia janë vetëm për qëllim informimi ose klasifikimi.

Shkurtimi “(s.p.)” është përdorur për të treguar që emri shkencor është përdorur në kuptimin e tij të gjerë.

Ylli (*) i vendosur pranë emrit të një specieje ose taksoni më të lartë tregon që specia ose një popullatë më e madhe e asaj specieje, ose një ose më shumë specie të përfshira në takson më të madh, janë përfshirë në Shtojcën I.

MAMMALIA

CHIROPTERA

Rhinolophidae	R. spp. (vetëm popullatat europiane)
Vesperulionidae	V. spp (vetëm popullatat europiane)
Molossidae	<i>Tadarida temotis</i>

CETACEA

Platanistidae	<i>Platanista gangetica</i>
Pontoporiidae	<i>Pontoporia marvillei</i>
Iriidae	
Monodontidae	<i>Delphinateris sp.</i> <i>Monodon monoceros</i>
Phocoentace	popullatat e Detit Balltik dhe të Veriut, Atlantikut VeriPerëndimor dhe Detit të Zi
	<i>Naopho phocaensides</i> <i>Phocoenoides dalli</i>
Delphinidae	<i>Sousa chinensis</i> <i>Sousa teusis</i> <i>Solaha fluvius</i> <i>Lagenorhyncus alopomis</i> (vetëm popullatat e Detit të Veriut e

Balltik)

Lagenorhyncus acutus (vetëm popullatat e Detit të Veriut e Balltik)

Lagenorhyncus australis

Grampus griseus (vetëm popullatat e Detit të Veriut e Balltik)

Tursiops trunatus (vetëm popullatat e Detit të Veriut e Balltik,

Mesdheut perëndimor dhe Detit të Zi,)

Stenella ateriata (popullatat e Paqësorit lindor në tropik)

Stenella longirostris (popullatat e Paqësorit lindor në tropik)

Stenella coeruleoalba (popullatat e Paqësorit lindor në tropik dhe

Mesdheun perëndimor)

Delphinus delphis (popullatat e Detit të Veriut, Balltik, Mesdheut perëndimor, Detit të Zi dhe Paqësorit lindor në tropik)

Orcaella brevirostris

Cephalorhynchus commersonii (popullatat e Amerikës Jugore)

Cephalorhynchus heavisidii

Orcinus orca (vetëm popullatat e Atlantikut të veriut dhe Paqësorit Verilindor)

Globicephala melas (vetëm popullatat e Detit të Veriut dhe Balltik)³

3) Të njohura më pare si *Globicephala melaena*

Berardius bairdii

Hyperoodon ampullatus

PINNIPEDIA

Phocidae

Phoca vitulina (vetëm në popullatat Detit Baltik dhe Wadden)

Halichoerus grypus (vetëm në popullatat Detit Baltik)

Monachus monachus *

PROBOSCIDEA

Elephantidae

Loxodonta africana

SIRENIA

Dugongidae

Dugong dugon

ARTIODACTYLA

Camelidae

Vicugna vicugna *⁴

4) Më parë e njohur si *Lama vicugna* *

Bovidae

Oryx dammah *

Gazella gazella (vetëm në popullatat aziatike)

AVES

GAVIIFORMES

Gaviidae

Gavia stellata (popullatat Palearktikut Verior)

Gavia artica artica

Gavia artica suschkini

Gavia immer immer (popullatat Evropës Veriperëndimore)

Gavia adamsii (popullatat Palearktikut Perëndimor)

PODICIPEDIFORMES

Podicipedidae

Podiceps grisegena grisegena

Podiceps auritus (popullatat Palearktikut Perëndimor)

PELECANIFORMES

Phalacrocoracidae

Phalacrocorax nigrogularis

Phalacrocorax pygmaeus

Pelecanidae

Pelecanus onocrotalus * (popullatat Palearktikut Perëndimor)

Pelecanus crispus *

CICONIIFORMES

Ardeidae

Butor stelleri stelleri (popullatat Palearktikut Perëndimor)

Ixobrychus minutus minutus (popullatat Palearktikut Perëndimor)

Ixobrychus sturmii

Ardeola rufiventris

Ardeola idae

Egretta vinaceigula

Casmerodius albus albus (popullatat Palearktikut Perëndimor)

Ardea purpurea purpurea (popullatat që follenizojnë në Palearktikut Perëndimor)

Ciconiidae

Mycteria ibis

Ciconia nigra

Ciconia episcopus microscelis

Ciconia ciconia

Plegadis falcinellus

Geronticus eremita *

Threskiornis aethiopicus aethiopicus

Platalea alba (duke përjashtuar popullatën Maljeziane)

Platalea leucorodia

Phoenicopteridae

Ph. spp.

ANSERIFORMES

Anatidae

*A.spp. **

FALCONIFORMES

Cathartidae

C.spp.

Pandionidae

Pandion haliaetus

Accipitridae

*A. spp. **

F. spp.

Falconidae

F.spp.

GALLIFORMES

Phasianidae

Coturnix coturnix coturnix

GRUIFORMES

Rallidae

Porzana porzana (popullatat që folenizojnë në Palearktikut Perëndimor) *Porzana parva parva*

Porzana pusilla intermedia

Fulica atra atra (popullatat Mesdhetare dhe të Detit të Zi)

Aenigmatolimnas maingalis

Sarothrura boehmi

Gruidae

*Grus spp. **

Anthropoides virgo

Otididae

*Chiamydotis undulate ** (vetëm në popullatat Aziatike)

*Otis tarda**

CHARADRIIFORMES

Recurirostridae

R.spp.

Dromadidae

Dromas ardeola

Burhinidae

Burhinus oedicnemus.

Glareolidae

Glareola pratincola

Glareola nordmanni

Charadriidae

C. spp

Scolopacidae

*S. spp.**

Phalaropodidae

P. spp

Laridae

Larus hemprichii

*Larus leucophthalmus **

Larus ichthyaetus (popullatat Euraziatike Perëndimore dhe Afrikane)

Larus melanocephalus

Larus genei

*Larus audouinii **

Larus armenicus

Sternidae

Sterna nilotica nilotica (popullatat Euraziatike Perëndimore dhe Afrikane)

Sterna caspia (popullatat Euraziatike Perëndimore dhe Afrikane)

Sterna maixima albidorsalis

Sterna bergii (popullatat Afrikane dhe Aziatike Jugperëndimore)

Sterna bengalensis (popullatat Afrikane dhe Aziatike Jugperëndimore) *Sterna*

sandvicënsis sandvicënsis

Sterna dougallii (popullatat atlantike)

Sterna hirundo hirundo (popullatat që folezizojnë në Palearktikut Perëndimor)

Sterna paradisaea (popullatat atlantike)

Sterna albifrons

Sterna saundersi

Sterna balaenarum

Sterna repressa

Chlidonias niger niger

Chlidonias leucapterus (popullatat EuroAziatike perëndimore dhe Afrikane)

CORACIIFORMES

Meropidae *Merops apiaster*
Coraciidae *Coracias garrulus*

PASSERIFORMES

Muscicapidae M. (s.l.) spp.

REPTILIA

TESTUDINATA

Cheloniidae

C. spp. *

Dermochelyidae

D. spp. *

Pelomedusidae

Podocnemis expansa *

CROCODYLIA

Crocodylidae

Crocodylus porosus

PISCES

ACIPENSERIFORMES

Acipenseridae

Acipenser fulvescens

INSECTA

LEPIDOPTERA

Danaiidae

Danaus plexippus

MIREKUPTIMI PËR MBROJTJEN E SHPENDEVE SHTEGTUES AFRIKANE EUROAZIATIKE

PALËT KONTRAKTUESE,

DUKE PERMENDUR që Konventa për Mbrojtjen e Specieve Shtegtuese të Kafshëve të Egra, 1979. kërkon veprime të përbashkëta ndërkombëtare për mbrojtjen e specieve shtegtuese;

DUKE PERMENDUR që takimi i parë i Konferencës së Palëve të Konventës, mbajtur në Bon në Tetor 1985. porositi Sekretariati e Konventës të marrë masat e duhura për të përgatitur një Mirëkuptim për Anatidet e Palearktikut Perëndimor:

DUKE KONSIDERUAR që shpendët shtegtues përbëjnë një pjesë të rëndësishme të shumëllojshmërisë biologjike që, duke patur parasysh Konventën e Shumëllojshmërisë Biologjike, 1992 dhe programin 21 duhet të mbrohen për të mirën e brezave të sotëm dhe të ardhshëm;

të

TË NDERGJEGJSHEM për përfitimet ekonomike, sociale, kulturore dhe shlodhëse prej disa specieve shtegtuese dhe vlerat mjedisore, ekologjike, gjenetike, shkencore, estetike, shplodhëse, edukative, sociale dhe ekonomike të shpendëve ujqorë në përgjithësi;

TË NDERGJEGJSHEM që kapja e shpendëve shtegtues duhet të kryhet sipas parimit të qëndrueshmërisë, duke marrë parasysh gjendjen e mbrojtjes së specieve në fjalë gjatë gjithë sipërfaqes së shtrirjes si dhe karakteristikat e tyre biologjike;

KOSHIENTE që shpendët shtegtues janë veçanërisht të dobët për arsye se shtegtojnë në distanca të gjata dhe varen nga zonat e lagëta që janë duke u pakësuar dhe duke u degraduar prej aktiviteteve njerëzore jo të qëndrueshme, siç shprehet në Konventën për Zonat e Lagëta me Rëndësi Ndërkombëtare, sidomos si Vendbanim për Shpendët, 1971,

DUKE KUJTUAR nevojën për të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të ndaluar pakësimin e specieve shtegtuese dhe vendbanimeve të tyre në zonën gjeografike të sistemeve shtegtuese të shpendëve Afrikano-Euroaziatikë.

TË NDERGJEGJSHEM që përgatitja e një Mirëkuptimi shumëpalësh dhe zbatimi i tij nëpërmjet veprimeve të koordinuara dhe konkrete do të kontribuojë në mënyrë të ndjeshme në mbrojtjen e shpendëve shtegtues dhe vendbanimeve të tyre në mënyrën më efektive, dhe do të ketë përfitime të ndjeshme për shumë specie të tjera kafshësh dhe bimësh; dhe

DUKE PRANUAR që zbatimi efektiv i këtij Mirëkuptimi do të kërkojë dhënien e ndihmës disa Shteteve Pjesëmarrëse për kërkim, trajnim dhe monitorim të specieve të shpendëve shtegtarë vendbanimeve të tyre, për menaxhimin e këtyre vendbanimeve si dhe krijimin ose përmirësimin e institucioneve shkencore dhe administrative për zbatimin

e këtij Mirëkuptimi;

RANE DAKORT SI VIJON:

NENI I

Shtrirja, Përkufizimet dhe Interpretimi

1. Shtrirja gjeografike e këtij Mirëkuptimi është zona e sistemit të shpendëve shtegtues të shpendëve Afrikano-Euroaziatik, siç përcaktohet në Shtojcën këtij Mirëkuptimi, që do të quhet "Zona e Mirëkuptimit".

2. Për qëllim të këtij Mirëkuptimi:

(a) "Konventë" kuptohet Konventa për Mbrojtjen e Shpendëve Shtegtarë të Kafshëve të Egra

(b) "Sekretariati i Konventës" kuptohet organizmi i krijuar sipas Nenit 9 të Konventës:

(c) "Shpendë Uji" kuptohen ato specie shpendësh që janë të varur ekologjikisht nga zonat e lagëta për të paktën një pjesë të ciklit vjetor të tyre, që kanë një përhapje që shtrihet tërësisht ose pjesërisht brenda Zonës së Mirëkuptimit dhe janë paraqitur në Shtojcën 2 të këtij Mirëkuptimi,

(d) "Sekretariati i Mirëkuptimit" kuptohet organizimi krijuar sipas Nenit VI, paragrafi 7, pika (b), e këtij Mirëkuptimi,

(e) "Palë" kuptohen, pavarësisht nëse shprehet dhe ndryshe, Palët në këtë Mirëkuptim, dhe

(f) "Palët prezent dhe që votojnë" kuptohen Palët prezent dhe që japin një votë pozitive ose negative; ato që abstenojnë votimin nuk do të llogariten midis Palëve që janë presentë dhe votojnë.

Termat e përcaktuar në Nenin 1, pikat l (a) deri (k), të Konventës do të kenë të njëjtin kuptim në këtë Mirëkuptim

3. Ky Mirëkuptim është një MIREKUPTIM sipas kuptimit të Nenit IV, paragrafi 3, i Konventës.

4. Shtojcat e këtij Mirëkuptimi përbëjnë një pjesë të integruar të tij. Çdo referim për Mirëkuptimin përfshin dhe referim për shtojcat e tij.

NENI II

Parimet kryesore

1. Palët duhet të ndërmarrin veprime të koordinuara për të ruajtur speciet e shpendëve shtegtues në një gjendje mbrojtje të favorshme ose ti çojnë ato në atë gjendje të tillë. Për këtë, ato duhet që brenda kufijve të tyre kombëtare masat e përshkruara në Nenin 3, së bashku me veprimet specifike të përcaktuara në Planin e Veprimit sipas Nenit 4, të këtij Mirëkuptimi.
2. Për zbatimin e masave të përshkruara në paragrafin I më sipër. Palët duhet të marrin parasysh parimin e parandalimit.

NENI III

Masat e Përgjithshme Mbrojtëse

1. Palët duhet të marrin masa për mbrojtjen e shpendëve shtegtues duke i kushtuar vëmendje të veçantë specieve të rrezikuara si dhe atyre me një gjendje mbrojtjeje të pafavorshme.
2. Palët duhet:
 - (a) të caktojnë të njëjtën mbrojtje strikte për speciet e rrezikuara të shpendëve shtegtare në Zonën e Mirëkuptimit siç thuhet në Nenin 3 paragrafët 4 dhe 5 të Konventës;
 - (b) të sigurojnë që çdo përdorim i shpendëve shtegtues është bazuar në vlerësimin e njohurive më të mira për ekologjinë e tyre dhe është e pranueshme për speciet si dhe për sistemet ekologjike që mbështesin ato,
 - (c) të përcaktojnë zonat dhe vendbanimet për shpendët shtegtues që shfaqen brenda territorit të tyre dhe të nxisin mbrojtjen, menaxhimin, rehabilitimin dhe rindërtimin e këtyre zonave, në bashkëpunimin me institucionet e treguara në Nenin 9, paragrafët (a) dhe (b) të këtij Mirëkuptimi, lidhur me mbrojtjen e vendbanimit,
 - (d) të koordinojnë përpjekjet e tyre për të siguruar që një rrjet vendbanimesh të përshtatshme mirëmbahet ose, aty ku është e mundur, ri-vendosur gjatë gjithë shtrirjes së çdo specie shtegtare të shpendëve në fjalë, në veçanti kur zonat e lagëta shtrihen në sipërfaqen e më shumë se një Palë në këtë Mirëkuptim;
 - (e) të zbulojnë probleme që janë shkaktuar ose që mund të shkaktohen nga aktivitetet njërëzore dhe të përpiqen të marrin masa përmirësuese, përfshirë rehabilitimin dhe ndërtimin e vendbanimeve, dhe masa kompensuese për humbjen e vendbanimeve;
 - f) të bashkëpunojnë në situata emergjente që kërkojnë veprim ndërkombëtar të bashkërenduar dhe të përcaktojnë speciet e shpendëve shtegtues që janë më të dobët

përpara këtyre situatave si dhe të bashkëpunojnë për përgatitjen e procedurave emergente për të siguruar mbrojtje të lartë për këto specie në këto raste dhe në përgatitjen e udhëzimeve për të ndihmuar Palët në kapërcimin e këtyre situatave,

(g) të ndalojnë hyrjen e qëllimshme të specieve jo-vendase të shpendëve në mjedis dhe të marin të gjitha masat e duhura për të parandaluar lëshimin e specieve të tilla nëse hyrja ose lëshimi dëmton mbrojtjen e florës dhe faunës së egër, kur speciet jo-vendase të shpendëve kanë hyrë. Palët duhet të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të parandaluar bërjen e këtyre specieve një rrezik i madh për speciet vendase;

(h) të fillojnë ose mbështesin kërkime për biologjinë dhe ekologjinë e Shpendëve shtegtues duke përfshirë harmonizimin e metodave të kërkimit dhe monitorimit dhe aty ku është e mundur realizimin e kërkimeve të përbashkëta dhe programeve të monitorizimit

(i) të analizojnë kërkësat e trenimit për vëzhgimin e shpendëve shtegëtues, monitorimin, rrjetin dhe menaxhimin e zonave të lagëta për të identifikuar çështjet prioritare dhe zonat për trenim dhe bashkëpunojnë në zvillimin e realizimin e programeve të përshtatshme të trenimit;

j) të përgatisin dhe realizojnë programe për të rritur ndërgjegjësimin dhe kuptimin e mbrojtjes së shpendëve shtegtues në përgjithësi dhe objektivave e kushteve të këtij Mirëkuptimi në veçanti;

(k) të shkëmbejnë informacion dhe rezultatet e programeve të kërkimit, monitorimit, mbrojtjes dhe edukimit; dhe

(l) të bashkëpunojnë me qëllim për të ndihmuar njëra tjetrën për të zbatuar këtë Mirëkuptim, veçanërisht në zonat e kërkimit dhe monitorimit.

Neni IV

Plani i Veprimit dhe Udhëzimet Mbrojtëse

1. Plani i Veprimit është vendosur në Shtojcën 3 të këtij Mirëkuptimi. Ai specifikon veprime që duhet të ndërmarrin Palët në lidhje me speciet dhe çështjet prioritare, sipas titujve të mëposhtëm, në përputhje me masat e përgjithshme mbrojtëse të specifikuara në Nenin III të këtij Mirëkuptimi:

(a) mbrojtja e specieve;

(b) mbrojtja e vendbanimeve;

I

(c) menaxhimi i aktiviteteve njërëzore;

(d) kërkimi dhe monitorimi;

(e) edukimi dhe monitorimi, dhe

(t) zbatimi.

2. Plani i Veprimit do të shikohet në çdo sesion të zakonshëm të Takimit të Palëve duke patur parasysh Udhëzimet Mbrojtëse.

3. Çdo shtesë në Planin e Veprimit do të miratohet nga Konferenca e Palëve, duke patur parasysh kushtet e Nenit 3 të këtij Mirëkuptimi.

4. Udhëzimet Mbrojtëse do të dorëzohen tek takimi i Palëve për miratim në sesionin e tij të parë, dhe do të rishikohen rregullisht.

NENI V

Zbatimi dhe Financimi

1. Çdo Palë duhet:

(a) të caktojë një ose disa institucione për të zbatuar këtë Mirëkuptim të cilët, ndër të tjera duhet të monitorojnë të gjitha aktivitetet që mund të kenë ndikim në situatën e mbrojtjes së atyre specieve të shpendëve shtegtues për të cilat Pala është Shtet Pjesëmarrës,

(b) Të caktojë një pikë kontakti për Palët e tjera, dhe të komunikojë pa vonesë emrin dhe adresën e tij tek sekretariati i Mirëkuptimit që do ti komunikohet më tej palëve të tjera, dhe

(c) të përgatiti për çdo sesion të zakonshëm të Takimit të Palëve, duke filluar nga sesioni i dytë, një raport mbi zbatimin e Mirëkuptimit nga ana e tij duke u përqëndruar tek masat mbrojtëse që ka marrë ajo. Përmbajtja e këtyre raporteve do të përcaktohet nga sesioni i parë i Takimit të Palëve dhe do të rishikohet nëse është e nevojshme në ndonjë sesion të mëvonshëm të Takimit të Palëve. Çdo raport duhet të dorëzohet tek sekretariati i Mirëkuptimit jo më pak se njëqind e njëzet ditë përpara sesionit të zakonshëm të Takimit të Palëve për të cilin është përgatitur, dhe kopje të tij duhen shpërndarë tek Palët e tjera prej sekretariatit të Mirëkuptimit.

2. (a) Çdo Palë duhet të kontribojë në buxhetin e Mirëkuptimit sipas shkallës së vlerësimit të Kombeve të Bashkuara. Kontributet duhet të kufizohen deri në një maksimum 25 për qind të buxhetit total për çdo Palë që është Shtet Pjesëmarrës. Organizatat për integrimin ekonomik rajonal do të kontribojnë jo më shumë se 2,5 për qind të kostove administrative

(b) Vendimet lidhur me buxhetin dhe çdo ndryshim në shkallën e vlerësimit shikohet e nevojshme duhet të miratohen nga Takimi i Palëve me konsensus.

3. Takimi i Palëve mund të krijojë një fond mbrojtjeje nga kontributet vullnetare të Palëve ose nga burime të tjera me qëllim financimin e monitorimit, kërkimit, trenimit dhe projekteve të lidhura me mbrojtjen, përfshirë dhe menaxhimin, për shpendët shtegtues.

4. Palët janë të inkurajuara të sigurojnë trenim dhe mbështetje teknike e financiare për Palët e tjera mbi baza shumëpalëshe ose dypalëshe për ti ndihmuar ato në zbatimin e kushteve të këtij Mirëkuptimi.

NENI VI

Takimi i Palëve

1. Takimi i Palëve do të jetë organi vendim marrës i këtij Mirëkuptimi

2. Depozituesi, në konsultim me Sekretariatit e Konventës, duhet të mbajë një sesion të Takimit të Palëve jo më vonë se një vit pas datës së hyrjes në fuqi të këtij Mirëkuptimi. Më tej, sekretariati i Mirëkuptimit duhet të mbajë, në konsultim me Sekretariatit e Konventës, sesione të zakonshme të Takimit të Palëve në intervale një herë në tre vjet, derisa Takimi i Palëve vendos ndryshe. Aty ku kjo është e mundur, sesione të tilla duhet të mbahen në të njëjtën kohë me takimet e zakonshme të Konferencës së Palëve të Konventës.

3. Me kërkesë të shkruar e të paktën një të tretës së Palëve, sekretariati i Mirëkuptimit duhet të mbajë një sesion të jashtëzakonshëm të Takimit të Palëve.

4. Kombet e Bashkuara, Agjencitë e saj të Specializuara, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, çdo Shtet që nuk është Palë në këtë Mirëkuptim dhe sekretariatet e konventave ndërkombëtare që lidhen ndër të tjera me mbrojtjen, përfshirë këtu dhe menaxhimin e shpendëve shtegtues mund të përfaqësohen si vëzhgues në sesionet e Takimit të Palëve. Çdo agjenci ose institucion i kualifikuar teknikisht në çështje të tilla të mbrojtjes ose në kërkime për shpendët shtegtues mundet gjithashtu të përfaqësohen në sesionet e Takimit të Palëve si vëzhgues, derisa të paktën një e treta e Palëve nuk paraqet ndonjë vërejtje

5. Vetëm Palët kanë të drejtë të votojnë. Çdo Palë ka vetëm një votë, por organizatat për integrimin ekonomik rajonal që janë Palë në këtë Mirëkuptim kanë të drejtë që, për çështje brenda kompetencave të tyre, të votojnë me një numër votash të barabartë me numrin e Shteteve të tyre Anëtarë që janë Palë në këtë Mirëkuptim. Një organizatë rajonale për integrimin ekonomik nuk do të këtë të drejtë të votojë kur Shtetet Anëtare të saj votojnë individualisht dhe anasjelltas.

6. Derisa mos të shprehet ndryshe në këtë Mirëkuptim, vendimet e Takimit të Palëve do të miratohen me konsensus ose, nëse konsensusi nuk arrihet me dy të tretën e numrit të palëve që janë prezent dhe që votojnë.

7. Në sesionin e tij të parë Takimi i Palëve duhet:

- (a) të miratojë rregullat e procedimit me konsensus
- (b) të krijojë një Sekretariat për Mirëkuptimin në kuadrin e Sekretariatit të Konventës për të ushtruar detyrat e sekretariatit të përmendura në Nenin 8 të këtij Mirëkuptimi.
- (c) të krijojë Komitetin Teknik sipas Nenit 7 të këtij Mirëkuptimi.
- (d) të përgatisë një format për raportet që do të përgatiten sipas Nenit 5 paragrafi 1, pika (c) të këtij Mirëkuptimi.
- (e) të përgatisë kritere për të përcaktuar rastet e situatave emergjente që kërkojnë masa urgjente mbrojtëse, dhe të përcaktojë kushtet për caktimin e përgjegjësive për veprimet që ndërmerren.

8. Në çdo sesion të zakonshëm të tij, Takimi i Palëve

- (a) të marrë në konsideratë ndryshimet aktuale dhe potenciale për mbrojtjen e shpendëve shtegtues dhe vendbanimeve të rëndësishme për jetesën e tyre, si dhe faktorët që mund të ndikojnë mbi to;
- (b) të shqyrtojë rezultatet e arritura dhe ndonjë vështirësi të ndeshur gjatë zbatimit të këtij Mirëkuptimi,
- (c) të miratojë buxhetin dhe marrë në konsideratë çështje që lidhen me përgatitjet financiare për këtë Mirëkuptim;
- (d) të lidhet për çështje që i takojnë sekretariatit të Mirëkuptimit dhe anëtarësisë në Komitetin Teknik,
- (e) të përgatisë një raport për komunikim me Palët e këtij Mirëkuptimi dhe me Konferencën e Palëve të Konventës, dhe
- (f) të caktojë kohën dhe vendin e sesionit tjetër.

9. Në çdo sesion të tij, Takimi i Palëve duhet:

- (a) të bejë rekomandime për Palët kur shihet e nevojshme ose e përshtatshme;
- (b) të përgatisë veprime specifike për përmirësimin e efektivitetit të këtij Mirëkuptimi dhe, sipas rastit, masat emergjente siç shprehet në Nenin 7, paragrafi 4, të këtij Mirëkuptimi,
- (c) të marrë në konsideratë dhe të vendosë për propozimet për ndryshimin e këtij Mirëkuptimi;

(d) të ndryshojë Planin e Veprimit në përputhje me Nenin 4, paragrafi 3 i këtij Mirëkuptimi.

(e) të krijojë organe ndihmëse kur është e nevojshme, për të ndihmuar në zbatimin e këtij Mirëkuptimi, veçanërisht për koordimin me organet e krijuara për traktatet, konventat dhe mirëkuptimet e tjera ndërkombëtare me mbivendosje gjeografike dhe shtrirje taksonomike dhe

(f) të vendosë për çështje të tjera që lidhen me zbatimin e këtij Mirëkuptimi.

NENI VII

Komiteti Teknik

1. Komiteti Teknik do të përbëhet nga:

(a) nëntë ekspertë që përfaqësojnë rajone të ndryshme të Zonës së Mirëkuptimit, në përputhje me një shpërndarje të balancuar gjeografike,

(b) një përfaqësues nga Bashkimi Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës dhe Burimeve Natyrore (IUCN), një nga Byroja e Kërkimeve Ndërkombëtare për Zonat e Lagëta dhe Shpendët (IWRB) dhe një nga Këshilli Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Florës e Faunës së Egër dhe asaj Objekt Gjuetie (CIC); dhe

(c) një ekspert nga fushat e mëposhtme: ekonomia rurale, menaxhimi i kafshëve dhe shpendëve të gjahut, dhe ligji i mjedisit.

Procedura për caktimin e ekspertëve, kohëzgjatja e caktimit të tyre dhe procedura për caktimin e Kryetarit të Komitetit Teknik do të caktohen nga Takimi i Palëve. Kryetari duhet të paraqesë maksimumi katër vëzhgues nga organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare dhe jo-qeveritare.

2. Derisa Takimi i Palëve të vendosë ndryshe, takimet e Komitetit Teknik do të thirren nga Sekretariati i Mirëkuptimit gjatë çdo sesi të zakonshëm të Takimit të Palëve dhe të paktën një herë ndërmjet sesioneve të zakonshme të Takimit të Palëve.

3. Komiteti Teknik duhet:

(a) të afrojë këshilla shkencore dhe teknike dhe informacion për Takimin e Palëve dhe nëpërmjet sekretariatit të Mirëkuptimit, për Palët;

(b) të bëjë rekomandime për Takimin e Palëve lidhur me Planin e Veprimit, zbatimin e Mirëkuptimit dhe kërkimeve të mëtejshme për t'u kryer:

(c) të përgatisë për çdo sesion të zakonshëm, të Takimit të Palëve një raport mbi aktivitetet e tij, i cili duhet të dorëzohet të sekretariatit i Mirëkuptimit jo më pak se njëqind e njëzet

ditë përpara sesionit të Takimit të Palëve dhe kopje e tij duhen shpërndarë nga sekretariati i Mirëkuptimit tek palët; dhe

(d) të kryejë detyra të tjera të caktuara nga Takimi i Palëve.

4. Kur në opinionin e Komitetit Teknik është shprehur një emergjencë që kërkon zbatimin e masave të menjëhershme për të shmangur degradimin e gjendjes mbrojtëse të një ose më shumë speciesth shpendësh shtegtues. Komiteti Teknik mund ti kërkojë sekretariatit të mirëkuptimit të thërrasë menjëherë një Takim të Palëve në fjalë. Këto Palë duhet të takohen sa më parë për të krijuar një mekanizëm për të mbrojtur speciet e përcaktuara si të rrezikuara. Kur miratohet një rekomandim në këtë takim, Palët në fjalë duhet të informojnë njëra-tjetrën dhe sekretariatit të Mirëkuptimit për masat që ato kanë marrë për zbatimin e tij, ose arsyet pse rekomandimi nuk mund të zbatohet.

5. Komiteti Teknik mund të krijojë grupe pune të tillë kur është e nevojshme për të kryer detyra specifike.

NENI VIII

Sekretariati i Mirëkuptimit

Funksionet e sekretariatit të Mirëkuptimit do të jenë:

(a) të organizojë dhe zhvillojë sesionet e Takimit të Palëve si dhe takimet e Komitetit Teknik;

(b) të zbatojë detyrat e caktuara ndaj tij prej Takimit të Palëve;

(c) të nxisë dhe kordinojë aktivitetet e Mirëkuptimit, përfshirë Planin e Veprimit, në përputhje me vendimet e Takimit të Palëve

(d) të komunikojë me Shtetet Pjesëmarrëse që nuk janë Palë dhe të lehtësojë bashkëpunimin midis Palëve dhe me organizatat ndërkombëtare e kombëtare, veprimtaria e të cilave lidhet direkt ose indirekt me mbrojtjen, përfshirë këtu dhe menaxhimin e shpendëve shtegtues.

(e) të mbledhë dhe vleresojë informacionin për plotësimin e objektivave dhe zbatimin e Mirëkuptimit dhe të realizojë shpërndarjen e duhur të këtij informacioni

(f) të tërheqë vëmendjen e Takimit të Palëve për çështje që lidhen me objektivat e këtij Mirëkuptimi

(g) të shpërndajë kopje të raporteve të Autoriteteve sipas Nenit 5, paragrafi 1 pika (a) të këtij Mirëkuptimi dhe të Komitetit Teknik, së bashku me kopje të raporteve që duhet të përgatish sipas paragrafit (h) të këtij Neni, tek çdo Palë jo më pak se 60 ditë përpara fillimit të çdo sesioni të zakonshëm të Takimit të Palëve

(h) të përgatisë çdo vit dhe për çdo sesion të zakonshëm të Takimit të Palëve, raporte për punën e sekretariatit dhe për zbatimin e Mirëkuptimit;

(p) të administrojë buxhetin e Mirëkuptimit dhe, nëse krijohet, fondin e tij të mbrojtjes

(j) të sigurojë informacion për publikun e gjerë lidhur me Mirëkuptimin dhe objektivat e tij; dhe

(k) të kryejë funksione të tjera të caktuara ndaj tij prej Mirëkuptimit ose nga Takimi i Palëve

NENI IX

Lidhjet me Organizmat Ndërkombëtare që punojnë në fushën e Shpendëve Shtegtues dhe Vendbanimeve të tyre

Sekretariati i Mirëkuptimit duhet të konsultohet:

(a) në mënyrë të rregullt, me Sekretariatit e Konventës dhe kur është e mundur, me organizmat përgjegjës për funksionet e sekretariatit sipas Mirëkuptimeve të realizuara sipas Nenit 4, paragrafi 3 dhe 4, të Konventës të cilet lidhen me shpendët shtegtues, Konventën për Zonat e Lagëta me Rendësi Ndërkombëtare, veçanërisht si Vendbanim për Shpendët, 1971, Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër, 1973, Konventa Afrikane për Mbrojtjen e Natyrës dhe Burimeve Natyrore, 1968, Konventa për Mbrojtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Vendbanimeve Natyrore, 1979, dhe Konventa për Shumëllojshmërinë Biologjike, 1992, duke u përqëndruar tek Takimet e Palëve në bashkëpunimin me Palët në këto konventa për të gjitha çështjet me interes të përbashkët dhe, në veçanti për zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Veprimt;

(b) me sekretariatet e konventave të tjera përkatëse dhe instrumentat ndërkombëtare lidhur me çështje me interes të përbashkët; dhe

(c) organizata të tjera kompetente në fushën e mbrojtjes, duke përfshirë mbrojtjen dhe menaxhimin e shpendëve shtegtues dhe vendbanimin e tyre, si dhe në fushën e kërkimeve, edukimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit.

NENI X

Ndryshimi i Mirëkuptimit

1. Ky Mirëkuptim mund të ndryshohet në çdo sesion të zakonshëm ose jashtëzakonshëm të Takimit të Palëve.

2. Propozime për ndryshime mund të bëhen nga çdo Palë.

3. Teksti i ndryshimit të propozuar dhe arsyet për të duhet ti komunikohen sekretariatit të Mirëkuptimit jo më pak se një qind e pesëdhjetë ditë përpara hapjes së sesionit.

Sekretariati i Mirëkuptimit duhet të dërgojë kopje Palëve. Çdo koment për tekstin nga Palët duhet ti komunikohet sekretariatit të Mirëkuptimit jo më pak se gjashtëdhjetë ditë përpara hapjes së sesionit. Sekretariati duhet që sa më parë pas ditës së fundit për dorëzimin e komenteve ti komunikojë Palëve të gjitha komentet e dorëzuara atë ditë.

4. Çdo ndryshim i Mirëkuptimit në ndryshim nga një ndryshim i shtojcave të tij duhet të miratohet nga dy të tretat e Palëve që janë prezent dhe që votojnë dhe do të hyjë në fuqi për ato Palë e kanë pranuar atë ditën e tridhjetë pas datës në të cilën dy të tretat e Palëve të Mirëkuptimit ditën e pranimit të ndryshimit kanë depozituar instrumentat e tyre të pranimit të ndryshimit tek Depozituesi. Për çdo Palë që depoziton instrumentat e pranimit pas datës në të cilën dy të tretat e Palëve kanë depozituar instrumentat e tyre të pranimit, ndryshimi do të hyjë në fuqi ditën e tridhjetë pas datës kur ajo depoziton instrumentin e saj të pranimit.

5) Çdo shtojcë tjetër dhe çdo ndryshim në një shtojcë duhet të miratohet prej dy të tretës së Palëve prezent dhe që votojnë dhe duhet të hyjë në fuqi për të gjitha Palët ditën e nëntëdhjetë pas datës së miratimit të tij nga Takimi i Palëve, përveç Palëve që kanë paraqitur një rezervë sipas paragrafit 6 të këtij Neni.

6. Gjatë periudhës nëntëdhjetë ditëshe sipas paragrafit 5 të këtij neni, çdo palë mundet që me njoftim të shkruar tek Depozituesi të paraqesë një rezervë për një shtojcë tjetër ose një ndryshim të një shtojcë. Kjo rezervë mund të tërhiqet në çdo kohë me një njoftim të shkruar tek Depozituesi, dhe me pas shtojca tjetër ose ndryshimi do të hyjë në fuqi për atë palë ditën e tridhjetë pas datës së tërheqjes së rezervës.

NENI XI

Ndikimi i këtij Mirëkuptimi tek Konventat dhe Legjislacioni Ndërkombëtar

1. Kushtet e këtij Mirëkuptimi nuk ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e çdo Palë që rrjedhin nga traktatet, konventat ose Mirëkuptimet ekzistuese ndërkombëtare.

2. Kushtet e këtij Mirëkuptimi nuk do të ndikojnë në të drejtën e çdo Palë të ruajë ose përshtasë masa strikte për mbrojtjen e shpendëve shtegtues dhe vendbanimet e tyre

NENI XII

Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

1. Çdo mosmarrveshje që mund të lindë midis dy ose më shumë Palëve lidhur me interpretimin ose aplikimin e kushteve të këtij Mirëkuptimi do të jetë objekt i bisedimeve midis palëve të përfshira në mosmarrveshje.
2. Nëse mosmarrveshja nuk mund të zgjidhet sipas Paragrafit 1 të këtij Neni, Palët mundet që me konsensus të përbashkët, të paraqesin mosmarrveshjen në gjyq, veçanërisht tek organizmi i përheshëm i Gjyqit në Hagë, dhe Palët që kanë paraqitur mosmarrveshjen duhet ti binden vendimit të gjyqit.

NENI XIII

Nënshkrimi, Ratifikimi, Pranimi, Aprovimi, Pëlqimi

1. Ky Mirëkuptim do të jetë i hapur për nënshkrim nga çdo Shtet Pjesëmarrës, nëse zonat nën juridiksionin e tij shtrihen ose jo në Zonën e Mirëkuptimit, ose organizatë për integrimin ekonomik rajonal, kur të paktën një anëtar i saj është Shtet Pjesëmarrës ose për:
 - (a) nënshkrim pa rezervë lidhur me ratifikimin, pranimin ose aprovimin; ose
 - (b) nënshkrimin me rezervë lidhur me ratifikimin, pranimin ose aprovimin, ndjekur nga ratifikimi, pranimi ose aprovimi.
2. Ky Mirëkuptim do të jetë i hapur për nënshkrim në Hagë deri në datën e hyrjes së tij në fuqi.
3. Ky Mirëkuptim do të jetë i hapur për pëlqim nga çdo Shtet Pjesëmarrës ose organizatë për integrimin ekonomik rajonal të përmendura në paragrafin I më sipër në dhe pas datës së hyrjes në fuqi të Mirëkuptimit.
4. Instrumentat e ratifikimit, pranimit, aprovimit ose pëlqimit duhet të depozitohen tek Depozituesi.

NENI XIV

Hyrja në Fuqi

1. Ky Mirëkuptim do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pasi të paktën katërmbëdhjetë Shtete Pjesëmarrëse ose organizata për integrimin ekonomik rajonal, që përbëhen të paktën nga shtatë prej Afrikës dhe shtatë nga Euroazia, e kanë nënshkruar pa

rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose aprovimin, ose kanë depozituar instrumentat e tyre të ratifikimit, pranimin ose aprovimit në përputhje me Nenin 13 të këtij Mirëkuptimi.

2. Për çdo Shtet Pjesëmarrës ose organizatë për integrimin ekonomik rajonal që ka:

(a) nënshkruar pa rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose aprovimin,

(b) ratifikuar, pranuar ose aprovuar; ose

(c) pëlqyer

këtë Mirëkuptim pas datës në të cilën numri i Shteteve Pjesëmarrëse dhe organizatave integrimin ekonomik rajonal i nevojshëm për të bërë të mundur hyrjen në fuqi e kanë nënshkruar atë pa rezerva ose e kanë ratifikuar, pranuar ose aprovuar atë, ky Mirëkuptim do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pas nënshkrimit pa rezerva, ose depozitimin, nga Shteti ose organizata, të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimin, aprovimit ose pëlqimit.

NENI XV

Rezervat

Kushtet e këtij Mirëkuptimi nuk do të jenë objekt i rezervave të përgjithshme. Sidoqoftë, një rezervë specifike mund të paraqitet nga çdo Shtet ose organizatë për integrimin ekonomik rajonal kur nënshkruan pa rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose aprovimin ose, kur është e nevojshme, kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimin, aprovimit ose pëlqimit lidhur me çdo specie të Mirëkuptimit ose çdo kusht specifik të Planit të Veprimit. Një rezervë e tillë mund të tërhiqet në çdo kohë nga Shteti ose organizata për integrimin ekonomik rajonal që e ka paraqitur atë, duke njoftuar me shkrim Depozituesin; ky Shtet ose organizatë - nuk do të detyrohet nga kushtet që janë objekt i rezervave deri në tridhjetë ditë pas datës në të cilën rezerva është tërhequr.

NENI XVI

Denoncimet

Çdo Palë mund të denoncojë këtë Mirëkuptim duke i shkruajtur Depozituesit në çdo kohë. Denoncimi do të këtë efekt dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën Depozituesi ka marrë njoftimin.

NENI XVII

Depozituesi

1. Originali i këtij Mirëkuptimi në Arabisht, Anglisht, Frengjisht dhe Rusisht, çdo variant i të cilit duhet të jetë i njëjtë, duhet të depozitohet tek Qeveria e Mbretërisë së Hollandës, e cila do të jetë Depozituesi. Depozituesi duhet të trasmetojë kopje të noterizuara të këtyre varianteve tek të gjitha Shtetet dhe organizatat për integrimin ekonomik rajonal sipas Nenit 13, Paragrafi 1, i këtij Mirëkuptimi, dhe tek sekretariati i Mirëkuptimit pasi ai të jetë krijuar.

2. Sapo ky Mirëkuptim të hyjë në fuqi, një kopje e noterizuar duhet të dërgohet nga Depozituesi tek Sekretariati i Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim sipas Nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

3. Depozituesi duhet të informojë të gjitha Shtetet dhe Organizatat për integrimin ekonomik rajonal që kanë nënshkruar ose pëlqyer këtë Mirëkuptimin dhe sekretariatit e Mirëkuptimit për:

(a) çdo nënshkrim

(b) çdo depozitim të instrumentave të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose pëlqimit.

(c) datën e hyrjes në fuqi të këtij Mirëkuptimi dhe çdo shtojcë tjetër si dhe çdo ndryshim të Mirëkuptimit ose shtojcave të tij;

(d) çdo rezervë lidhur me një shtojcë tjetër ose një ndryshim të një shtojcë;

(e) çdo njoftim për tërheqjen e një rezervë; dhe

(f) çdo njoftim për denoncimin e Mirëkuptimit.

Depozituesi duhet të trasmetojë tek të gjitha Shtetet dhe organizatat për integrimin ekonomik rajonal që kanë nënshkruar ose pëlqyer këtë Mirëkuptim dhe tek sekretariati i Mirëkuptimit, tekstin e çdo rezervë, e çdo shtojcë tjetër dhe çdo ndryshimi të Mirëkuptimit ose Shtojcave të tij.

Në praninë e tyre nënshkruarit të autorizuar për këtë çështje, kanë nënshkruar këtë Mirëkuptim.


SHTOJCA I

Percaktimi i Zones se Mirekuptimit

Kufiri i zones se Mirekuptimit eshte percaktuar si vijon: nga Poli i Veriut ne jug pergjate meridianit perendimor 130 grade deri tek ai 75 grade verior; prej ketej ne lindje dhe juglindje neper ngushticen Viskount Melville, grykes se Princit Regent, Gjirit te Boothia, Ujrave Foxe, Kanalit Foxe dhe Ngushtices Hudson ne nje pike

ne veriperendim te Atlantikut ne 60 grade veri, 60 grade perendim; prej ketej ne juglindje nepermjet veriperendimit te Atlantikut ne nje pike 50 grade veri, 30 grade perendim, prej jugut pergjate meridianit 30 grade deri tek ai 10 grade verior; prej juglindjes ne Ekuator ne 20 grade perendim; ne jug pergjate meridianit 20 grade perendimor deri tek 40 grade jug; ne lindje pergjate paralelit 40 grade jug deri tek 60 grade lindje; ne veri pergjate meridianit 60 grade lindje deri tek 35 grade veri; tie lindje-verilindje ne nje rreth te madh deri tek nje pike ne perendim te Altai-it ne 49 grade veri. 87 grade e 27' lindje: ne verilindje ne nje rreth te madh tek bregdeti i Oqeanit Arktik ne 130 grade lindje, ne veri pergjate meridianit 130 grade ne lindje tek Poli i Veriut. Skica e Zones se Mirekuptimit eshte paraqitur, ne harten bashkengjitur

Harta e zones se marreveshjes...



Shtojca 2

Llojet e shpendeve ujore per te aplikohet kjo Marreveshje

GAVIIDAE

Gavia stellata

Gavia arctica

Gavia immer

Gavia adamsii

PODICIPEDIDAE

Podiceps grisegena

Podiceps auritus

PELECANIDAE

Pelecanus onocrotalus

Pelecanus crispus

PHALACROCORACIDAE

Phalacrocorax pygmaeus

Phalacrocorax nigrogularis

ARDEIDAE

Egretta vinaceigula

Ardea purpurea

Casmerodius albus

Ardeola idae

Ardeola rufiventris

Ixobrychus minutus

Ixobrychus sturmii

Botaurus stellaris

CICONIIDAE

Mycteria ibis

Ciconia nigra

Ciconia episcopus

Ciconia ciconia

THRESKIORNITHIDAE

Plegadis falcinellus

Geronticus eremita

Threskiornis aethiopicus

Platalea leucorodia

Platalea aalba

PHOENICOPTERIDAE

Phoenicopterus ruber

Phoenicopterus minor

ANATIDAE

Dendrocygna bicolor

Dendrocygna viduata

Thalassornis leuconotus

Oxyura leucocephala

Cygnus olor

Cygnus cygnus

Cygnus columbianus

Anser brachyrhynchus

Anser fobalis

Anser albifrons

Anser erythropus

Anser anser

Branta leucopsis

Branta bernicla

Branta ruficollis

Alopochen aegyptiacus

Tadorna ferruginea

Tadorna cana

Tadorna tadorna

Plectropterus gambensis

Sarkidiornis melanotos

Nettapus auritus

Anas penelope

Anas strepera

Anas crecca

Anas capensis

Anas platyrhynchos

Anas undulata

Anas acuta

Anas erythrorhyncha

Anas hottentota

Anas querquedula

Anas clypeata

Marmaronetta angustirostris

Netta rufina

Netta erythrophthalma

Aythya ferina

Aythya nyroca
Aythya fuligula
Aythya marila
Somateria mollissima
Somateria spectabilis
Polysticta stelleri
Clangula hyemalis
Melanitta nigra
Melanitta fusca
Bucephala clangula
Mergellus albellus
Mergus serrator
Mergus merganser

GRUIDAE

Grus leucogeranus
Grus virgo
Grus paradises
Grus carunculatus
Grus grus

RALLIDAE

Sarothrura boehmi
Porzana parva
Porzana pusilla
Porzana porzana
Aenigmatolimnas marginalis
Fulica atra (Deti i Zi / Mesdhe)

DROMADIDAE

Dromas ardeola

RECURVIROSTRIDAE

Himantopus himantopus
Recurvirostra avosetta

GLAREOLIDAE

Glareola pratincola
Glareola nordmanni

CHARADRIIDAE

Pluvialis apricaria
Pluvialis squatarola
Charadrius hiaticula
Charadrius dubius
Charadrius pecuarius
Charadrius tricollaris
Charadrius forbesi
Charadrius pallidus
Charadrius alexandrinus
Charadrius marginatus
Charadrius mongolus
Charadrius leschenaultii
Charadrius asiaticus
Eudromias morinellus
Vanellus vanellus
Vanellus spinosus
Vanellus albiceps
Vanellus senegallus
Vanellus lugubris
Vanellus melanopterus
Vanellus coronatus
Vanellus superciliosus
Vanellus gregarius
Vanellus leucurus

SCOLOPACIDAE

Gallinago media
Gallinago gallinago
Lymnocyptes minimus
Limosa limosa
Limosa lapponica
Numenius phaeopus
Numenius tenuirostris
Numenius arquata
Tringa erythropus
Tringa totanus
Tringa stagnatilis
Tringa nebularia
Tringa ochropus
Tringa glareola
Tringa cinerea
Tringa hypoleucos
Arenaria interpres

Calidris tenuirostris
Calidris canutus
Calidris alba
Calidris minuta
Calidris temminchii
Calidris maritima
Calidris alpina
Calidris ferruginea
Limicola falcinellus
Philomachus pagnax
Phalaropus lobatus
Phalaropus fulicaria

LARIDAE

Larus leucophthalmus
Larus hemprichii
Larus audouinii
Larus armenicus
Larus ichthyaetus
Larus genei
Larus melanocephalus
Sterna nilotica
Sterna caspia
Sterna maxima
Sterna bengalensis
Sterna bergii
Sterna sanavicensis
Sterna dougallii
Sterna hirundo
Sterna paradisaea
Sterna albifrons
Sterna saundersi
Sterna balaenarum
Sterna repressa
Chlidonias leucopterus
Chlidonias niger

PLANI I VEPRIMIT

1. Fushën e Veprimit

1.1 Plani i Veprimit është i zbatueshëm për popullatat e shpendëve shtegtues të paraqitura në Tabelën I të kësaj Shtojcë (që këtej e tutje përmendur si "Tabela I").

Tabela I përbën një pjesë të përbashkët me këtë Shtojcë. Cdo referim në Planin e Veprimit përfshin një referim në Tabelën 1.

2. Mbrojtja e Specieve

2.1 Masat ligjore

2.1.1 Planet me popullata që ndodhen në kolonën A të tabelës I duhet të mbrojnë ato popullata që tregohen sipas Nenit 3 paragrafi 2 (a), të këtij Mirëkuptimi. Këto Palë duhet që në veçanti dhe sipas paragrafit 2.1.3 më poshtë:

a) të ndalojnë kapjen e zogjve dhe vezëve të atyre popullatave që shfaqen në territorin e tyre;

(b) të ndalojnë shqetësimin e qëllimshëm kur ky bëhet i dukshëm për mbrojtjen e popullatave në fjalë; dhe

(c) të ndalojnë zotërimin ose përdorimin dhe tregtinë e zogjve ose vezëve të atyre popullatave që janë kapur në kundërshtim me kushtet e paraqitura në pikën (a) me sipër, si dhe zotërimi ose përdorimi dhe tregtia e çdo pjese të dukshme ose pasardhësi të këtyre zogjve dhe vezëve të tyre.

Në rast të përjashtimeve për ato popullata të paraqitura në Kategoritë 2 dhe 3 vetëm në Kolonën A (ose të cilat janë shënuar me yll, gjuetia mund të vazhdojë mbi bazën e përdorimit të qëndrueshëm kur gjuetia e këtyre popullatave është praktike kulturore që ekziston prej kohësh. Ky përdorim i qëndrueshëm do të realizohet brenda kuadrit të kushteve të veçanta të planit të veprimit të species në nivel ndërkombëtar.

2.1.2 Palët me popullatat e përmendura në Tabelën 1 duhet të rregullojnë kapjen e zogjve dhe vezëve të të gjitha popullatave të përmendura në kolonën B të Tabelës 1. Objekti i masave të tilla ligjore do të jetë të mirëmbajë ose kontribuojë në rehabilitimin e këtyre popullatave në një gjendje mbrojtje të favorshme dhe të sigurojë, mbi bazën e njohurive më të mira për dinamikën e popullatave, që çdo kapje ose përdorim tjetër është i qëndrueshëm. Masat të tilla ligjore, sipas paragrafit 2.1.3 më poshtë, duhet që në veçanti:

(a) të ndalojnë kapjen e zogjve që i takojnë popullatave në fjalë gjatë fazave të ndryshme të riprodhimit dhe rritjes dhe gjatë kthimit të tyre tek vendet e shumëzimit nëse kapja ka ndikim të pafavorshëm mbi mbrojtjen e popullatave në fjalë;

(b) të rregullojnë mënyrat e kapjes;

(c) të vendosin kufij për kapjet, kur është e mundur, dhe të sigurojnë kontroll të duhur për të bërë të mundur vëzhgimin e limiteve; dhe

(d) të ndalojnë zotërimin ose përdorimin dhe tregtinë e zogjve dhe vezëve të popullatave që janë kapur në kundërshtim me kufizimet e vëna sipas kushteve të këtij paragrafi si dhe zotërimi ose përdorimi dhe tregtia e çdo pjese të këtyre

2.1.3 Palët mund të paraqesin përjashtime për kufizimet e paraqitura në paragrafët nga kushtet e Nenit 3, paragrafi 5, të Konventës, kur nuk ka mundësi për zgjidhje tjetër të kënaqshme, për arsyt në vijim:

(a) të parandalojnë dëmtimin serioz të drithrave, ujit dhe peshkut,

(p) në interes të sigurisë së ajrit dhe çështje të tjera me interes publik

(c) për qëllim të kërkimit dhe edukimit, për ri-vendosjen dhe për shumëzimin e nevojshëm për këto qëllime,

(d) të lejojmë mbi bazën e kushteve strikte të mbikqyrjes, mbi baza seleksionuese dhe në një zgjatje të kufizuar, kapjen dhe ruajtjen ose përdorime të tjera të arsyeshme të disa zogjve në sasi të vogël, dhe

(e) me qëllim të rritjes së numrit ose mbijetesës së popullatave në fjalë.

Këto përjashtime do të përcaktohen në përmbajtje dhe kufizohen në hapësirë dhe kohë dhe nuk do të veprohet në dëm të popullatave të paraqitura në Tabelën 1. Palët duhet që sa më parë të informojnë sekretariatit e Mirëkuptimit për ndonjë përjashtim të caktuar sipas këtij kushti.

Planet e Veprimit për Speciet e Vetme

Palët duhet të bashkëpunojnë për të përgatitur dhe zbatuar plane veprimi për speciet e vetme me rëndësi ndërkombëtare për popullatat e përmendura në Kategorinë I të Kolonës A në Tabelën I me prioritet dhe për popullatat e shënuara me yll në Kolonën A të Tabelës 1. Sekretariati i Mirëkuptimit duhet të koordinojë përgatitjen, harmonizimin, përgatitjen dhe zbatimin e këtyre planeve.

2.2.2 Palët duhet të përgatisin dhe zbatojnë plane veprimi për speciet e vetme me rëndësi kombëtare të popullatave të treguara në Kolonën A të Tabelës 1 me

qëllim përmirësimit e mbrojtjes së tyre. Ky plan veprimi duhet të përfshijë kushte specifike për popullatat e shënuara me yll. Në rastet kur ndodh vrasja aksidentale e zogjve nga gjuetarët, për arsye të përcaktimit të gabuar të specieve, kjo duhet marrë në konsideratë.

2.3 Masat emergjente

Palët duhet, që në bashkëpunim të ngushtë me njëra-tjetrën kur është e mundur dhe e përshtatshme, të përgatisin dhe zbatojnë masa emergjente për popullatat e njohura në Tabelën 1, kur, në raste të veçanta në Zonën e Mirëkuptimit shfaqen kushte të pafavorshme ose të rrezikshme.

2.4 Ri-vendosjet

2.4 Palët duhet të bëjnë kujdesin me të madh për rivendosjen e popullatave të treguara në Tabelën 1 në ato pjesë të shtrirjes tradicionale të tyre ku ato mungojnë. Ato duhet të përpipen të përgatisin dhe ndjekin një plan të detajuar ri-vendosjeje të bazuar në studime shkencore. Planet e ri-vendosjes duhet të përbëjnë një pjesë të rëndësishme të planeve të veprimit kombëtar e ndërkombëtar të specieve të vetme. Një plan ri-vendosje duhet të përfshijë vlerësimin e ndikimit mbi mjedisin dhe duhet të përdoret gjërësisht. Palët duhet të informojnë, përpara sekretariatit e Mirëkuptimit, për të gjithë programin e ri-vendosjes për popullatat e treguara në Tabelën 1.

2.5 Hyrjet

2.5.1 Palët duhet, që kur e shohin të nevojshme, të ndalojnë hyrjen e specieve jo-vendase të kafshëve dhe bimëve të cilat mund të demtojnë popullatat e treguara në Tabelën 1.

2.5.2 Palët duhet që kur e shohin të nevojshme, të kërkojnë marrjen e masave paraprake për të shmangur largimin aksidental të zogjve të kapur që i takojnë specieve jo-vendase.

2.5.3 Palët duhet të marrin masa paraprake dhe të përshtatshme, përfshirë këtu kapjen, për të bërë të mundur që kur speciet jo-vendase ose hibridet e tyre kanë hyrë në territorin e tyre, ato nuk përbëjnë një rrezik potencial për popullatat e treguara në Tabelën 1.

3. Mbrojtja e Vendbanimeve

3.1 Inventari i Vendbanimeve

3.1.1 Palët, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare kompetente, duhet të kryejnë dhe publikojnë inventare kombëtare të vendbanimeve në territorin e

tyre të cilat janë të rëndësishme për popullatat e treguara në Tabelën 1.

3.1.2 Palët duhet, që me prioritet të përcaktojnë të gjitha zonat me rëndësi kombëtare e ndërkombëtare për popullatat e treguara në Tabelën 1.

3.2 Mbrojtja e Zonave

3.2.1 Palët duhet të vazhdojnë shpalljen e zonave të mbrojtura për të mbrojtur vendbanimet e rëndësishme për popullatat e treguara në Tabelën 1, dhe të përgatisin dhe zbatojnë Plane menaxhimi për këto zona.

3.2.1 Palët duhet ti sigurojnë mbrojtje të veçantë atyre zonave të lagëta që plotësojnë kriteret e pranuar ndërkombëtare me rëndësi ndërkombëtare.

3.2.2 Palët duhet të përdorin gjërësisht dhe në menyrë të qëndrueshme të gjitha zonat e lagëta në territorin e tyre. Në veçanti ato duhet të përpiqen të shmangin degradimin e vendbanimeve që ndihmojnë popullatat e treguara në Tabelën 1 nëpërmjet zbatimit të rregullave ose standarteve dhe masave të kontrollit. Në veçanti, ato duhet:

(a) të sigurojnë zbaatimin e kontrolleve të ligjshme lidhur me përdorimin e kimikateve në bujqësi, procedurat për kontrollin e dëmtuesve dhe shkarkimin e ujrave të ndotura, të cilat duhet të jenë në përputhje me normat ndërkombëtare, me qëllim minimizimin e ndikimit të dëmshëm mbi popullatat e treguara në Tabelën 1, dhe

(b) të përgatisin dhe shpërndajnë materiale informative, me një gjuhë të kuptueshme, duke përshkruar këto rregullore, standarte dhe masat e kontrollit që ekzistojnë dhe përfitimet e tyre për njerëzit dhe florën e faunën e egër.

3.2.4 Palët duhet të përgatisin strategji, sipas konceptit të ekosistemit, për mbrojtjen e vendbanimeve për të gjitha popullatat e treguara në Tabelën 1, duke përfshirë dhe vendbanimet e atyre popullatave që janë shpërndarë.

3.3 Rehabilitimi dhe Rindërtimi

Palët duhet të rehabilitojnë ose rindërtojnë, aty ku është e mundur, zonat të cilat kanë qënë të rëndësishme për popullatat e treguara në Tabelën 1.

4. Menaxhimi i Aktiviteteve Njerëzore

4.1 Gjuetia

4.1.1 Palët duhet të bashkëpunojnë për të siguruar që legjislacioni i tyre i gjuetisë përmban principin e përdorimit të qëndrueshëm siç përmendet në këtë Plan Veprimi, duke marrë parasysh shtrirjen e plotë gjeografike të popullatave të

shpendëve në fjalë dhe karakteristikat historike të jetës së tyre

4.1.2 Sekretariati i Mirëkuptimit duhet të informohet nga palët për legjislacionin e tyre lidhur me gjuetinë e popullatave të treguara në Tabelën 1.

4.1.3 Palët duhet të bashkëpunojnë për të përgatitur një sistem të besueshëm dhe të harmonizuar për grumbullimin e të dhënave për vjeljet me qëllim të vlerësimit të vjeljes së popullatave të treguara në Tabelën 1. Ato duhet ti paraqesin sekretariatit të Mirëkuptimit vjeljet vjetore për çdo popullate, kur është e mundur.

4.1.4 Palët duhet të përpiqen të heqin përdorimin e gjuetisë me plumb në zonat e lagëta deri në vitin 2000.

4.1.5 Palët duhet të përgatisin dhe zbatojnë masa për të reduktuar dhe sa të jetë e mundur të eliminojnë, përdorimin e ushqimeve helmuese.

4.1.6 Palët duhet të përgatisin dhe zbatojnë masa për të reduktuar dhe sa të jetë e mundur të eliminojnë kapjen e paligjshme;

4.1.7 Kur është e nevojshme Palët duhet të inkurajojnë gjuetarët, në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, për të krijuar klube ose organizata për kordinimin e aktiviteteve të tyre dhe të ndihmojnë për të siguruar qëndrueshmëri.

4.1.8 Palët duhet që, kur është e nevojshme, të kërkojnë kryerjen e një testi zotësie për gjuetarët, duke përfshirë midis të tjerave, identifikimin e zogjve.

4.2 Eko-turizmi

4.2.1 Palët duhet të inkurajojnë, aty ku është e mundur por jo në zonat qendrore të zonave të mbrojtura, përgatitjen e programeve të bashkëpunimit midis të gjitha palëve të interesuara për zhvillimin e ekoturizmit të përshtatshëm dhe të ndjeshëm në zonate e lagëta që kanë përqëndrime të popullatave të treguara në Tabelën 1.

4.2.2 Palët, në bashkëpunim me organizatat kompetente ndërkombëtare, duhet të marrin masa për vlerësimin e kostove, përfitimeve dhe pasojave të tjera që mund të rezultojnë nga eko-turizmi në zonat e lagëta të zgjedhura me përqëndrim të popullatave të treguara në Tabelën 1. Ato duhet ti komunikojnë rezultatet të këtyre vlerësimeve të Sekretariati i Mirëkuptimit.

4.3 Aktivitetet e Tjera Njerëzore

4.3.1 Palët duhet të vlerësojnë ndikimin e projekteve të propozuara të cilet mund të çojnë në konflikte midis popullatave të treguara në Tabelën 1 të cilat ndodhen

në zonat e treguara në paragrafët 3.2 dhe me interes njerëzor, dhe duhet ti bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.

4.3.2 Palët duhet të përpiqen të grumbullojnë informacion për dëmin, veçanërisht në drithërat, të shkaktuara nga popullatat e treguara në Tabelën 1, dhe të raportojnë mbi rezultatet tek sekretariati i Mirekuptimit.

4.3.3 Palët duhet të bashkëpunojnë për përcaktimin e teknikave të duhura për minimizimin e dëmit, ose për të lehtësuar efektet e dëmit. Veçanërisht tek drithërat të shkaktuar nga popullatat e treguara në Tabelën 1, duke u bazuar në ekspëriencën e deritanishme në botë.

4.3.4 Palët duhet të bashkëpunojnë për përgatitjen e planeve të veprimit për specie të vetme populatave që shkaktojnë dëm të dukshëm, veçanërisht tek drithërat. Sekretariati i Mirëkuptimit duhet të koordinojë përgatitjen për monitorimin e këtyre planeve.

4.3.5 Palët duhet që, sa më shumë të jetë e mundur të kërkojnë standarte të larta mjedisore në planifikimin dhe ndërtimin e strukturave të ndryshme për të minimizuar ndikimin e tyre mbi popullatat e treguara në Tabelën 1. Ato duhet të marrin masa për të minimizuar ndikimin e strukturave ekzistuese kur është e dukshme që ato kanë ndikim negativ për popullatat në fjalë.

4.3.6 Në rastet kur shqetësimi nga njeriu rrezikon mbrojtjen e popullatave të shpendëve të treguara në Tabelën 1, Palët duhet të marrin masa për të zvogëluar nivelin e rrezikut. Masat duhet të përfshijnë përcaktimin e zonave që nuk shqetësohen brenda zonave të mbrojtura ku dhe hyrja e njeriut është e ndaluar.

5. Kerkimi dhe Monitorimi

5.1 Palët duhet të kryejnë vëzhgime pune në zonat më pak të njohura, në të cilat mund të këtë përqendrime të rëndësishme të popullatave të treguara në Tabelën 1. Rezultatet e këtyre vëzhgimeve duhet të bëhen të njohura gjerësisht.

5.2 Palët duhet të monitorojnë popullatat e treguara në Tabelën 1. Rezultatet e këtij monitorimi duhet të publikohen ose dërgohen tek organizatat ndërkombëtare kompetente, për të bërë të mundur njohjen e gjendjes dhe të ardhmes së popullatës.

5.3 Palët duhet të bashkëpunojnë për të përmirësuar njohjen e së ardhmes së popullatave të zogjve si një kriter për përshkrimin e gjendjes së këtyre popullatave.

5.4 Palët duhet të bashkëpunojnë për të përcaktuar rrugët e shtegimit të të gjithë popullatave të treguara në Tabelën 1, duke përdorur njohuritë ekzistuese të

rezultateve të shpërndarjes dhe numrit gjatë sezonit të shumëzimit dhe jashtë tij, dhe duke marrë pjesë në programet e unazimit.

5.5 Palët duhet të fillojnë dhe mbështesin projekte të përbashkëta kërkimi për ekologjinë dhe dinamikën e popullatave të treguara në Tabelën 1 dhe vendbanimet e tyre, për të përcaktuar kërkesat tyre specifike si dhe teknikat që janë më të përshtatshme për mbrojtjen dhe menaxhimin e tyre.

5.6 Palët duhet të kryejnë studime për efektet e humbjes dhe degradimit të zonave të lagëta dhe shqetësimin e kapacitetit mbajtës të tyre prej popullatave të treguara në Tabelën 1 dhe në format e shtegimit të këtyre popullatave.

5.7 Palët duhet të kryejnë studime për ndikimin e gjuetisë dhe tregtisë mbi popullatat e treguara në Tabelën 1 dhe për rëndësinë e këtyre formave të përdorimit për ekonominë lokale dhe kombëtare.

5.8 Palët duhet të bashkëpunojnë me organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe të mbështesin projekte kërkimi dhe monitorimi.

6. Edukimi dhe Informimi

6.1 Palët duhet që, aty ku është e nevojshme, të përgatisin programe trajnimiti për të siguruar përgatitjen e duhur të personelit që është përgjegjës për zbatimin e këtij Plani Veprimi.

6.2 Palët duhet të bashkëpunojnë me njera-tjetrën dhe sekretariatit e Mirëkuptimit me qëllim që të realizojnë programe trajnimiti dhe të shkëmbejnë materiale.

6.3 Palët duhet të përgatisin programe, materiale informative dhe mekanizma për të përmirësuar nivelin e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë lidhur me objektivat, kushtet dhe përmbajtjen e këtij Plani Veprimi. Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet atyre njerëzve që jetojnë në dhe përreth zonave të lagura të rëndësishme, përdoruesve të tyre (gjuetarë, peshkatarë, turistë, etj.) dhe autoriteteve lokale dhe personave të tjerë vendimmarres.

6.4 Palët duhet të kryejnë fushata të veçanta për ndërgjegjësimin e publikut për mbrojtjen e popullatave të treguara në Tabelën 1.

7. Zbatimi

7.1 Gjatë zbatimit të Planit të Veprimit, Palët duhet ti japin prioritet popullatave të treguara në Kolonën A të Tabelës 1.

7.2 Kur, në rastin e popullatave të treguara në Tabelën 1, me shumë së një

popullate e të njejtave specie shfaqet në territorin e një Palë, kjo Palë duhet të marrë masa mbrojtëse për popullatën ose popullatat që kanë mbrojtje me të dobët.

7.3 Sekretariati i Mirekuptimit, në bashkëpunim me Komitetin Teknik dhe me ndihmën e ekspertëve nga Shtetet Pjesmarrëse, duhet të koordinojë përgatitjen e udhëzimeve mbrojtëse sipas Nenit 4, paragrafi 4, të këtij Mirëkuptimi për të ndihmuar Palët në zbatimin e këtij Plani Veprimi. Sekretariati i Mirëkuptimit duhet të sigurojë, bashkëveprim me udhëzimet e miratuara sipas instrumentave të tjere ndërkombëtare. Keto udhëzime për mbrojtjen duhet të kenë si qëllim principin e përdorimit të qëndrueshëm. Ato duhet që të mbulojnë:

(a) planet e veprimit të specieve të vetme:

(b) masat emergjente

(c) përgatitjen e metodave për inventarizimin e zonave e manaxhimin e vendbanimeve,

(d) praktikat e gjuetisë,

(e) tregtinë e shpendëve,

(f) turizimi:

(g) reduktimin e dëmtimit të drithrave, dhe

(h) një protokoll për monitorimin e shpendëve.

7.4 Sekretariati i Mirekuptimit, në bashkëpunim me Komitetin Teknik dhe Palët duhet të përgatisë një radhë vëzhgimesh ndërkombëtare të nevojshme për zbatimin e Planit të Veprimit, duke përfshirë:

(a) raporte mbi gjendjen dhe të ardhmen e popullatave;

(b) mangësitë në informacion nga vëzhgimet,

(c) rrjetin e zonave të përdorura nga çdo popullatë, përfshirë këtu vëzhgimin e situatës mbrojtëse për çdo zonë si dhe të masave menaxhuese të marra në çdo rast;

(d) gjuetinë dhe legjislacionin e tregtisë në çdo vend lidhur me speciet e treguara në Shtojcën 2 të këtij Mirekuptimi;

(e) fazën e përgatitjes dhe zbatimit të planeve të veprimit për speciet e vetme;

(f) projektet ri-vendosjes; dhe

(g) gjendjen e specieve të hyra jo-vendase dhe hibridet e tyre.

7.5 Sekretariati i Mirëkuptimit duhet të sigurojë që vëzhgimet e përmendura në paragrafin 7.4 janë aktualizuar në intervale jo me shumë së çdo tre vjet.

7.6 Komiteti Teknik duhet të vendosë të vlerësojë udhëzimet dhe vëzhgimet e përgatitura sipas paragrafëve 7.3 dhe 7.4 dhe duhet të përgatisë projekt rekomandime dhe rezoluta lidhur me përgatitjen, përmbajtjen dhe zbatimin e tyre për të marrë në konsideratë nga Takimi i Palëve.

7.7 Sekretariati i Mirëkuptimit duhet që rregullisht të ndërmarrë një vëzhgim të mekanizmave të mundshëm për të siguruar burime shtesë (fonde dhe asistencë teknike) për zbatimin e këtij Plani Veprimi dhe duhet të përgatisë një raport për çdo sesion të zakonshëm të Takimit të Palëve.

Tabela 1

GJENDJA E POPULLATAVE TË SHPEDEVE SHTETUES

SHpjegimi i Klasifikimit

Shpjegimi i mëposhtëm i Tabelës 1 është bazë për zbatimin e Planit të Veprimit:

Kolona A

Kategoria 1:

- (a) Speciet që janë përfshirë në Shtojcën 1 të Konventës;
- (b) Speciet që janë treguar të rrezikuara në Listën e Kuqe të Kafshëve të Rrezikuara IUCN 1994 (Groombridge 1993); ose
- (c) Popullatat që numërojnë më pak së 10.000 individë.

Kategoria 2:

Popullatat që numërojnë midis 10.000 dhe 25.000 individë.

Kategoria 3:

Popullatat që numërojnë midis 25.000 dhe 100-000 individë dhe konsiderohen të rrezikuara si rezultat i:

- (a) përqëndrimin në një numër të vogël zonash në çdo fazë të ciklit të tyre vjetor
- (b) varësisë nga një tip vendbanimi i cili është nën një rrezik të fortë; (c) tregimit të një rënieje të dukshme afat-gjatë; ose
- (d) tregimit të ndryshueshmërive ekstreme në madhësinë e popullatës ose të ardhmen e saj.

Për speciet e treguara në Kategoritë 2 dhe 3, më sipër, shiko paragrafin 2.1.1 të kësaj Shtojcë.

Kolona B

Kategoria 1

Popullatat që numërojnë midis 25.000 dhe 100.000 individë dhe të cilat nuk plotësojnë kushtet sipas Kolonës A, siç përshkruhet më sipër.

Kategoria 2:

Popullatat që numërojnë më shumë së 100.000 individë dhe që kanë nevojë për vëmendje të veçantë si rezultat i:

- (a) përqëndrimin në një numër të vogël zonash në çdo fazë të ciklit të tyre vjetor;
- (b) varësisë nga një lloj vendbanimi që është nën një rrezik të fortë; (c) tregimit të një rënie të dukshme afat-gjatë; ose
- (d) tregimit të ndryshueshmërive të medha në madhësinë e popullatave ose të

ardhmen e tyre.

Kolona C

Kategoria 1: Popullatat që numërojnë me shumë së 100.000 individë të cilet mund të përfitojnë dukshëm nga bashkëpunimi ndërkombëtar dhe që nuk plotësojnë kushtet sipas Kolonave A ose B, më sipër.

VEZHGIMI I TABELES 1

Kjo Tabelë duhet:

(a) të rishikohet rregullisht nga Komiteti Teknik sipas Nenit 7. paragrafi 3 (b), i këtij Mirëkuptimi; dhe

(b) të ndryshohet nga Takimi i Palëve, sipas Nenit 6, paragrafi 9(d) i këtij Mirëkuptimi sipas konkluzioneve të këtyre rishikimeve.

SHJEGIMI I SHKURTIMEVE DHE SIMBOLEVE

bre: shumëzimi

win: dimërimi

N: Verior

E: Lindor

S: Jugor

W: Perëndimor

NË: Verilindor

NW: Veripërëndimor

SË: Jugiindor

SW: Jugpërëndimor

1: Gjendje popullore e panjohur. Gjendja e mbrojtjes e vlerësuar.

*: Shiko paragrafin 2. 1. 1

SHENIME

1. Të dhënat e popullatave të përdorura për të plotësuar Tabelën 1 i korespondojnë numrit të individëve në gjendje shumëzimi të mirë në Zonën e Mirëkuptimit. Gjendja është bazuar në vlerësimet më të mira të publikuara të popullates.

2. Shkurtime (bre) ose (win) në listën e popullatave janë vetëm ndihmëse për identifikimin e popullatës. Ato nuk tregojnë kufizime sezonale për vëprimet në lidhje me ato popullata sipas këtij Mirëkuptimi dhe Plani Veprimi.

	A	B	C
<u>Mycteria ibis</u>			
E gjithë popullata		1	
Ciconia nigra			
Afrika Perëndimore/ Evropa Perëndimore	1c		
Evropa Qendrore dhe Lindore (folezues)	2		
<u>Ciconia episcopus</u>			
Afrika e tropikut (C. e microscelis)		1	
<u>Ciconia ciconia</u>			
Afrika Jugore (C. c. ciconia)	1c		
Afrika Veri-perëndimore/ Evropa perëndimore	3b		
Evropa Qendrore dhe Lindore (C. c. ciconia)		2c	
Azia Perëndimore (C. c. ciconia)	3b		
<u>Plegadis falcinellus</u>			
Afrika Sahara Jugore (P. f. falcinellus)			1'
Afrika Perëndimore dhe Evropa (P. f. falcinellus)		1	
Afrika lindore/ Azia Jug-perëndimore (P. f. falcinellus)	2*		
<u>Geronticus eremita</u>			
Morocco	1a		
Azia Jug-perëndimore	1a		
<u>Threskiornis aethiopicus</u>			
Jug Sahara/ Afrikë (T. a. aethiopicus)			1
Irak/ Iran (T. a. aethiopicus)	1c		
<u>Platalea leucorodia</u>			
Atlantiku Lindor (P.l. leucorodia)	1c		
Evropa Qendrore dhe Lindore (folezues) (P.l. leucorodia)	2		
Deti i Kuq (P. l. archeri)	1c		
Azia Jugore dhe Jug-Perëndimore (dimërues) (P.l. major)	2		
<u>Platalea alba</u>			
E gjithë popullata	2*		
<u>Dendrocygna bicolor</u>			
Afrika			1
<u>Dendrocygna viduata</u>			
Afrika			1
<u>Thalassornis leuconotus</u>			
Afrika jug-lindje (T. l. leuconotus)	2*		
Afrika e perëndimit (T. l. leuconotus)	1c		
<u>Oxyura leucocephala</u>			
Mesdheu Perëndimor	1a		
Mesdheu Lindor dhe Azia Perëndimore	1a		
<u>Cygnus olor</u>			
Evropa Veriperëndimore		2d	
Deti i Zi (dimërues)	2		
Deti Kaspik (dimërues)		2a & 2d	

<u>Cygnus cygnus</u>			
Islanda (folezues)	2		
Evropa Veri-perëndimore (dimërues)		1	
Deti i Zi (dimërues)	2		
Azia Perëndimore (dimërues)	2 ¹		
<u>Cygnus columbianus</u>			
Evropa (C.c. bewickii) (dimërues)	2		
Deti Kaspik (C.c. bewickii) (dimërues)	1c		
<u>Anser brachyrhynchus</u>			
Islanda (folezues)		2a	
Svalbard (folezues)		1	
<u>Anser fabalis</u>			
Taiga perëndimore (A.f. fabalis) (folezues)		1	
Tundra perëndimore (A.f. rossicus) (folezues)			1
<u>Anser albifrons</u>			
Evropa Veri-perëndimore (A.a. albifrons) (dimërues)			1
Evropa Qendrore (A.a. albifrons) (dimërues)		2c	
Deti i Zi (A.a. albifrons) (dimërues)			1
Deti Kaspik (A.a. albifrons) (dimërues)	2		
Groelanda (A.a. flavirostris) (folezues)	3a*		
<u>Anser erythropus</u>			
Deti i Zi dhe Kaspik (dimërues)	1b		
<u>Anser anser</u>			
Islanda (A.a. anser) (folezues)		1	
Evropa veriore/ Mesdheu perëndimor (A.a. anser)			1
Evropa Qendrore/ Afrika veriore (A.a. anser)	2*		
Deti i Zi (A.a. anser) (dimërues)		1	
Siberia perëndimore/ deti Kaspik (A.a. anser)		1	
<u>Branta leucopsis</u>			
Groelanda (folezues)		1	
Svalbard (folezues)	2		
Rusia (folezues)			1
<u>Branta bernicla</u>			
Siberia (B.b. bernicla) (folezues)		2b	
Svalbard (B.b. hrota) (folezues)	1c		
Islanda (B.b. hrota) (dimërues)	2		
<u>Branta ruficollis</u>			
E gjithë popullata	1b		
<u>Alopochen aegyptiacus</u>			
E gjithë popullata			1 ¹
<u>Tadorna ferruginea</u>			
Mesdheu Perëndimor	1c		
Mesdheu Lindor/ Deti i Zi	2		
Azia Jug-perëndimore		1	
<u>Tadorna cana</u>			
E gjithë popullata		1	
<u>Tadorna tadorna</u>			
Evropa Veri-perëndimore		2a	

Mesdheu Perëndimor	2		
Deti i Zi		1	
Deti Kaspik		1	
Plectropterus gambensis			
Afrika Perëndimore (P. g. gambensis)			1
Afrika Jugore (P. G. niger)		1	
Sarkidiornus melanotos			
Afrikë (S. m. melanotos)			1 ¹
Nettapus auritus			
Afrika Perëndimore	1c		
Afrika Juglindore			1 ¹
Anas penelope			
Evropa Veriperëndimore (dimërues)			1
Deti i Zi / Mesdhe (dimërues)		2c	
Azia Jugperëndimore (dimërues)		2c	
Anas strepera			
Evropa Veriperëndimore (dimërues) (A. s. strepera)		1	
Deti i Zi / Mesdhe (dimërues) (A. s. strepera)		1	
Azia Jugperëndimore (dimërues) (A. S. strepera)			1
Anas crecca			
Evropa Veriperëndimore (dimërues) (A.c. crecca)			1
Deti i Zi / Mesdhe (dimërues) (A. c. crecca)			1
Azia Jugperëndimore (dimërues) (A.c. crecca)		2c	
Anas capensis			
E gjithë poullata			1 ¹
Anas platyrhynchos			
Evropa Veriperëndimore (dimërues) (A. p. platyrhynchos)			1
Deti i Zi / Mesdhe (dimërues) (A. p. platyrhynchos)		2c	
Azia Jugperëndimore (dimërues) (A. p. platyrhynchos)			1
Anas undulata			
Afrika Jugore (A. u. undulata)		1	
Anas acuta			
Afrika Perëndimore (dimërues)			1
Evropa Veriperëndimore (dimërues)		1	
Deti i Zi / Mesdhe (dimërues)		2c	
Azia Jugperëndimore / Afrika Lindore (dimërues)			1
Anas erythrorhyncha			
Afrika Juglindore			1
Anas hottentota			
Afrika Perëndimore	1c ¹		
Afrika Juglindore			1 ¹
Anas querquedula			
Afrika Perëndimore (dimërues)			1
Afrika Lindore / Azi (dimërues)			1
Anas clypeata			

Evropa Veriperëndimore (dimërues)		1	
Mesdheu Perëndimor (dimërues)		2a	
Deti i Zi / Mesdhe (dimërues)			1
Azia Jugperëndimore (dimërues)			1
Marmaronetta angustirostris			
Mesdheu Perëndimor		1b	
Mesdheu Lindor		1b	
Azia Jugperëndimore		1b	
Netta rufina			
Evropa Jugperëndimore dhe Qendrore	2*		
Evropa Juglindore	3c		
Azia Jugperëndimore			1
Netta erythrophthalma			
Afrika Juglindore (N. e. brunnea)			1 ¹
Aythya ferina			
Evropa Veriperëndimore (dimërues)		2c	
Deti i Zi / Mesdhe (dimërues)		2c	
Azia Jugperëndimore		2c ¹	
Aythya nyroca			
Afrika (dimërues)	1c		
Evropa (dimërues)	3c		
Azia Jugperëndimore	1c		
Aythya fuligula			
Evropa Veriperëndimore (dimërues)			1
Deti i Zi / Mesdhe (dimërues)			1
Azia Jugperëndimore (dimërues)			1
Aythya marila			
Atlantiku Lindor (dimërues) (A. m. marila)			1
Deti i Zi / Deti Kaspik (dimërues) (A. m. marila)		1	
Somateria mollissima			
Evropë (S. m. mollissima)			1
Somateria spectabilis			
Evropa Verilindore			1
Polysticta stelleri			
Evropa Verilindore (dimërues)	2		
Clangula hyemalis			
Islandë / Groenlandë (folezues)		2c	
Evropa Veriperëndimore (dimërues)			1
Deti Kaspik	1c		
Melanitta nigra			
Evropa Veriperëndimore (dimërues) (M. n. nigra)		2a	
Melanitta fusca			
Evropa Veriperëndimore (dimërues) (M. f. fusca)		2a	
Deti i Zi / Deti Kaspik (dimërues) (M. f. fusca)	1c		
Bucephala clangula			
Evropa Veriperëndimore (dimërues) (B. C. clangula)			1
Deti Zi / Mesdhe (dimërues) (B. c. clangula)	2*		
Deti Kaspik (dimërues) (B. c. clangula)	2		

Mergellus albellus			
Evropa Veriperëndimore (dimërues)	3a		
Deti i Zi / Mesdhe (dimërues)		1	
Azia Jugperëndimore (dimërues)		1	
Mergus serrator			
Evropa Veriperëndimore (dimërues) (M. s. serrator)			1
Deti i Zi / Mesdhe (dimërues) (M. s. serrator)		1	
Azia Jugperëndimore (dimërues) (M. S. serrator)	1c		
Mergus merganser			
Evropa Veriperëndimore (dimërues) (M. m. merganser)			1
Deti i Zi / Mesdhe (dimërues) (M. m. merganser)	1c		
Azia Jugperëndimore (dimërues) (M. m. merganser)	2		

MIRËKUPTIM PËR MBROJTJEN E GJITARËVE TË DETIT TË ZI, MESDHE ZONAVE NE KUFI ME ATLANTIKUN

Palët,

Duke ripërmendur që Konventa për Mbrojtjen e Specieve Shtegtuese të Kafshëve të Egra, 1979, inkurajon veprime të përbashkëta ndërkombëtare për mbrojtjen e specieve shtegtuese;

Duke ripërmendur që takimi i tretë i Konferencës së Palëve të Konventës, mbajtur në Gjenevë në Shtator 1991, i kërkoi Shteteve Pjesëmarrëse të bashkëpunojnë për të përgatitur, nën kujdesin e Konventës, një mirëkuptim shumëpalësh për mbrojtjen e gjitarëve të vegjël të Deteve Mesdhe dhe të Zi;

Duke kujtuar që gjitarët janë pjesë përbërëse e ekosistemeve detare që duhen mbrojtur për të mirën e gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme, dhe që mbrojtja e tyre është çështje e përhershme;

Duke kujtuar rëndësinë e integritit të veprimeve për mbrojtjen e gjitarëve me aktivitetet që lidhen me zhvillimin social-ekonomik të Shteteve që lidhen me Mirëkuptimin, duke përfshirë aktivitetet detare si peshkimi dhe lëvizjen e lirë të anijeve në përputhje me ligjin ndërkombëtar,

Të ndërgjegjshëm që statusi i mbrojtjes së gjitarëve mund të ndryshojë nga faktorë të tillë si degradimi dhe shqetësimi i vendbanimeve të tyre, ndotja, pakësimi i burimeve të ushqimit, përdorimi dhe lënia e paisjeve të peshkimit, dhe nga kapjet e qëllimshme dhe të rastit;

Të bindur që dobësia e gjitarëve ndaj këtyre rreziqeve pengon zbatimin e masave të

veçanta mbrojtëse, aty ku ato nuk ekzistojnë, prej Shteteve ose organizatave rajonale të bashkëpunimit ekonomik që kanë pavarësi ditë/ose ushtrojnë juridiksion në pjesë të territorit të tyre, dhe nga Shtetet, kufijtë shtetërorë të të cilëve shtrihen jashtë limiteve ne juridiksion kombëtar për aktivitetet që mund të ndikojnë mbrojtjen e gjitarëve;

Duke nënvizuar nevojën për të nxitur dhe lehtësuar bashkëpunimin midis Shteteve, organizatave për integrimin ekonomik rajonal, organizatave ndërqeveritare dhe sektorin jo-qeveritar për mbrojtjen e gjitarëve të Detit të Zi, Mesdhe, të ujrave që lidhin këto dete, dhe zonat në kufi me Atlantikun;

Të bindur që përgatitja e një mirëkuptimi shumëPalësh dhe zbatimi i tij nëpërmjet veprimeve të koordinuara, bashkërenduara do të kontribuojë dukshëm në mbrojtjen e gjitarëve dhe vendbanimeve të tyre në mënyrën më të efektshme, dhe do të ketë përfitime ndihmesë për speciet e tjera;

Duke pranuar, që pavarësisht nga kërkimet shkencore të së kaluarës ose të tashmet, njohuritë e biologjisë, ekologjisë, dhe, dinamika e popullatës së gjitarëve janë të pamjaftueshme, dhe është e nevojshme të zhvillohet bashkëpunimi për kërkim dhe monitorimin e këtyre specieve me qëllim që të zbatohen plotësisht masat mbrojtëse;

Duke pranuar për më tej që zbatimi efektiv i këtij mirëkuptimi do të kërkojë ndihmë që do të sigurohet, nën frymën e solidaritetit, për disa Vende Pjesmarrëse për kërkimin, treininin, dhe monitorimin e gjitarëve dhe vendbanimeve të tyre, si dhe krijimin ose përmirësimin e institucioneve shkencore dhe administrative;

Duke kujtuar rëndësinë e instrumentave të tjerë globale dhe rajonale që lidhen me mbrojtjen e gjitarëve, nënshkruar nga shumë Palë, të tilla si Konventa Ndërkombëtare për Rregullimin e Balenave, 1946; Konventa për Mbrojtjen e Detit Mesdhe kundër Ndotjes, 1976, protokollet e saj dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen e Gjitarëve në Detin Mesdhe përgatitur në këtë kuadër në 1991; Konventa për Mbrojtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Vendbanimeve Natyrore, 1979, Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ligjin e Detit 1982; Konventa e Shumëllojshmërisë Biologjike, 1992; Konventa për Mbrojtjen e Detit të Zi kundër Ndotjes, 1992; dhe Plani Global i Veprimit për Mbrojtjen, Menaxhimin, dhe Përdorimin e Gjitarëve të Detit të Programit të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin, miratuar në 1984; si dhe iniciativat *ndër të tjera* të Këshillit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun, Komisionit Ndërkombëtar për Kërkimin Shkencor të Mesdheut, dhe Komisionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Atlantikut.

Ranë dakort si vijon:

Neni I

Shtrirja, Përkufizimet dhe interpretimi

1. a) Shtrirja gjeografike e këtij Mirëkuptimi, që do të quhet më pas "zona e Mirëkuptimit", përbëhet nga të gjitha ujrat detare të Detit të Zi dhe Mesdhe dhe gjiret e

detet e tyre, dhe ujrat e brendshme që lidhen ose që lidhin këto ujra detare, dhe të zonës së Atlantikut në kufi me Detin Mesdhe në përendim të Ngushticës së Gjibratarit. Për qëllim të këtij Mirëkuptimi:

- Deti i Zi është i kufizuar në jug-përendim nga vija që lidh Kepin Kelaga dhe Dalyan (Turqi);

- Deti Mesdhe është i kufizuar në lindje nga kufuri jugor i Ngushticës së Dardaneleve midis fareve të Mehmetcik dhe Kumkale (Turqi dhe në përendim me meridianin që kalon përmes Kepit far të Spartel në hyrje të Ngushticës së Gjibraltarit; dhe

- Zona në kufi me Atlantikun në përendim të Ngushticës së Gjibraltarit është e kufizuar në lindje me meridianin që kalon përmes Kepit fanar të Spartel dhe në përendim nga vija që bashkon faret e Kepit të Shën Vicente (Portugali dhe Kazablanka (Marok)

b) Asgjë në këtë Mirëkuptim dhe as ndonjë akt përgatitur mbi bazën e këtij Mirëkuptimi nuk do të paragjykojë të drejtat dhe detyrimet, pakënaqësitë e tashme dhe të ardhme ose pikpamjet ligjore të ndonjë Shteti lidhur me ligjin e detit ose Konventa e Montrealit e 20 Korrikut 1936, në veçanti natyra dhe shtrirja e zonave detare, c'kufizimi i zonave detare midis Shteteve me brigjet përkundrejt ose përbri, lirinë e lundrimit në detet e mëdha, të drejtën dhe modalitetet e kalimit nëpër ngushtica përdorur për lundrimin ndërkombëtar dhe të drejtën e kalimeve të paqëllimshme në ujrat territoriale, si dhe natyra dhe shtrirja e juridiksionit të Shtetit bregdetar, Shtetit flamur dhe Shtetit port.

c) Asnjë akt ose aktivitet i ndërmarrë mbi bazën e këtij Mirëkuptimi do të kushtëzojë arsye për pakënaqësi, konkurim ose kundërshtim për ndonjë shkelje të sovranitetit ose juridiksionit kombëtar.

2. Ky Mirëkuptim aplikohet për të gjithë gjitarët që kanë një shtrirje të plotë ose pjesore në zonën e Mirëkuptimit ose që aksidentalisht ose rastësisht frekuentojnë zonën e Mirëkuptimit, një listë treguese e të cilës është në Shtojcën I të këtij Mirëkuptimi.

3. Për qëllim të këtij Mirëkuptimi:

a) "Gjitarë" kuptohen kafshët, përfshirë individet e specieve, nënspecieve ose popullatave të *Odontoceti* ose *Mysticetti*;

b) "Konventë" kuptohet Konventa për Mbrojtjen e Specieve Shtegtuese të Kafshëve të Egra, 1979,

c) "Sekretariat i Konventës" kuptohet organi i krijuar sipas Nenit IX të Konventës;

d) "Sekretariati i Mirëkuptimit" kuptohet organi krijuar sipas Nenit III, paragrafi 7, i këtij Mirëkuptimi;

e) "Komiteti Shkencor" kuptohet organi krijuar sipas Nenit III, paragrafi 7, i këtij Mirëkuptimi;

f) "Pjesmarrje" kuptohet të gjitha zonat me ujë që një gjitar popullon, qëndron përkohësisht, ose kalon në çdo kohë gjatë rrugës normale të migrimit brenda zonës së Mirëkuptimit.

g) "Shtet Pjesmarrës" kuptohet çdo Shtet që ushtron sovranitetin dhe/ose juridiksionin mbi pjesë të pjesmarrjes së popullatës së gjitarëve të mbuluara nga ky Mirëkuptim, ose një Shtet, kufijtë e të cilit përfshihen në aktivitetet në zonën e Mirëkuptimit që mund të ndikojë mbrojtjen e gjitarëve.

h) "Organizatë për integrimin ekonomik rajonal" kuptohet një organizatë e krijuar nga Shtetet e pavarura që ka kompetencë lidhur me negociatat, konkluzionet dhe aplikimin e mirëkuptimeve ndërkombëtare për çështje që mbulohen nga ky Mirëkuptim;

p "Palë" kuptohet një Shtet Pjesmarrës ose një organizatë për integrimin ekonomik rajonal për të cilën ky Mirëkuptim është në forcë;

j) "Nënrajon", në varësi të kuptimit të veçantë, kuptohet rajoni që përbëhet nga Shtetet bregdetare të Detit të Zi ose rajoni që përbëhet nga Shtetet bregdetare të Detit Mesdhe dhe zona në kufi me Atlantikun; çdo referencë në Mirëkuptim për Shtetet e një nënrajonit të veçantë do të kuptohet për Shtetet që kanë pjesë të ujrave territoriale brenda atij nënrajonit, dhe Shtetet kufijtë e të cilëve janë përfshirë në aktivitete që mund të ndikojnë në mbrojtjen e gjitarëve në atë nënrajon, dhe

k) "Vendbamin" kuptohet një zonë në shtrirjen e gjitarëve ku ata janë përkohësisht ose përherë banorë, në veçanti, zonat e ushqimit, thellësitë e lindjes dhe shumëzimit, dhe rrugët e migrimit.

Për më tej, termat e përcaktuar në Nenin 1, pikat I "a-e", dhe "i" të Konventës do të kenë të njëjtin kuptim, në këtë Mirëkuptim.

4. Ky Mirëkuptim është një mirëkuptim brenda kuptimit të Nenit IV, paragrafi 4, të Konventës.

5. Shtojcat e këtij Mirëkuptimi formojnë një pjesë të integruar, dhe çdo referencë për Mirëkuptimin përfshin një referencë për shtojcat e tij.

Neni II

Qëllimi dhe Masat Mbrojtëse

1. Palët duhet të marrin masa të koordinuara për të arritur dhe mbajtur një gjendje të favorshme mbrojtje për gjitarët. Për këtë qëllim Palët duhet të ndalojnë dhe marrin të

gjitha masat e nevojshme për të eliminuar, aty ku kjo nuk është bërë, çdo kapje të paligjshme të gjitarëve dhe duhet të bashkëpunojnë për të krijuar dhe ruajtur një rrjet të zonave veçanërisht të mbrojtura për të mbrojtur gjitarët.

2. Cdo Palë mund të kërkojë përjashtim nga kushtet e kërkuara në pikën e mësipërme vetëm në situata emergjencë siç parashikohet në Shtojcën 2, pika 6, ose, pas marrjes së keshillës nga Komitëti Shkencor, për qëllime *in situ* kërkimesh me qëllim të mbajtjes së një gjendje mbrojtjeje të favorshme për gjitarët. Pala në fjalë duhet të njoftojë, menjëherë Byronë dhe Komitetin Shkencor, nëpërmjet sekretariatit të Mirëkuptimit, për çdo përjashtim të lejuar, Sekretariati i Mirëkuptimit duhet të informojë të gjitha Palët për përjashtimin pa vonesë me mjetet më të përshtatshme.

3. Më tej, Palët duhet të aplikojnë, brenda mundësive të sovranitetit dhe/ose juridiksionit dhe në përputhje me obligimet e tyre ndërkombëtare, mbrojtjen, kërkimin dhe masat menaxhuese të përshkruara në Shtojcën 2 të këtij Mirëkuptimi, që duhet të adresojnë çështjet e mëposhtme:

a) përshtatja dhe forcimi i legjislacionit kombëtar;

b) vlerësimi dhe menaxhimi i ndërthurjeve njëri-gjitar;

c) mbrojtja e vendbanimeve;

d) kërkimi dhe monitorimi,

e) krijimi i mundësive, mbledhja dhe shpërndarja e informacionit, trainimi dhe edukimi; dhe

t) përgjigja ndaj situatave emergjente

Masat lidhur me aktivitetet e peshkimit do të aplikohen në të gjitha ujrat nën sovranitetin dhe/ose juridiksionin dhe jashtë këtyre ujrave në përputhje me territoret jashtë vendit mëmë ose të regjistruar brenda territorit të tyre.

4. Në zbatimin e masave të përshkruara më sipër, Palët duhet të aplikojnë principet paraprake.

Neni III Takimi i Palëve

1. Takimi i Palëve do të jetë organi vendim-marrës për këtë Mirëkuptim.

2. Depozituesi duhet të mbajë, në konsultim me Sekretariatit e Konventës, një sesion të Takimit të Palëve për këtë Mirëkuptim jo më vonë se më vit pas datës së hyrjes së tij në fuqi. Për më tej, sekretariati i Mirëkuptimit duhet të thërrasë, në bashkëpunim me Sekretariatit e Konventës, sesione të zakonshme të Takimit të Palëve në intervale jo më

shumë së tre vjet, pavarësisht së Takimi i Palëve vendos ndryshe.

3. Sekretariati i Mirëkuptimit duhet të mbajë një sesion të jashtëzakonshëm të Takimit të Palëve me kërkesë të shkruar e të paktën 2/3 së Palëve.

4. Kombet e Bashkuara, Agjencite e tij specializuara, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, çdo Shtet që nuk është Palë në këtë Mirëkuptim, sekretariatet e konventave ose mirëkuptimeve të tjera globale dhe rajonale të lidhura *ndër të tjera* me mbrojtjen e gjitarëve, dhe organizatat rajonale ose nënrajonale për menaxhimin e peshkimit me kompetenca për speciet e gjetura përkohësisht ose përherë rezidente në zonën e Mirëkuptimit mund të përfaqësohet me vëzhgues në sesionet e Takimit të Palëve. Cdo agjenci ose organizëm teknikisht i kualifikuar ne mbrojtjen e gjitarëve mund të përfaqësohet në sesionet e Takimit të Palëve me vëzhgues, pavarësisht së të paktën 1/3 e Palëve prezente kundërshton. Pasi pranohet ne një sesion të Takimit të Palëve, një vëzhgues ka të vazhdojë të caktohet të marrë pjesë në sesionet e ardhshme pavarësisht së 1/3 e Palëve kundërshton të paktën 30 ditë para fillimit të sesionit.

5. Vetëm Palët kanë të drejtë të votojnë. Cdo Palë ka një vote. Organizatat për integrimin ekonomik- rajonal që janë Palë të këtij Mirëkuptimi do të ushtrojnë, për çështje brenda kompetencave të tyre të drejtën për të votuar me një numër votash të barabartë me numrin e Shteteve anëtare që janë Palë në këtë Mirëkuptim. Një organizate rajonale për integrimin ekonomik nuk do të ketë të drejtë vote nëse Shtetet anëtare të saj e kanë këtë dhe e kundërta.

6. Të gjitha vendimet e Takimit të Palëve do të miratohen me konsensus përveç siç thuhet ndryshe në Nenin X të këtij Mirëkuptimi. Sidoqoftë, nëse konsensusi nuk arrihet në lidhje me çështjet e trajtuara nga shtojcat e këtij Mirëkuptimi, një vendim do të merret prej 2/3 së Palëve prezent dhe që votojnë. Në rastin e votimit, çdo Palë mundet, që brenda 150 ditëve, të njoftojë Depozituesin duke shkruar mendimin e tij për mos zbatimin e vendimit në fjalë.

7. Ne sesionin e tij të parë, Takimi i Palëve duhet:

a) të miratojë rregullat e punës;

b) të krijojë një sekretariat të Mirëkuptimit për të kryer funksionet e sekretariatit të listuara Nenin IV të këtij Mirëkuptimi,

c) të caktojë në çdo nënrajon, brenda një institucioni ekzistues, një njësi Ko-ordinuese për të lehtësuar zbatimin e masave të përshkruara në Shtojcën 2 të këtij Mirëkuptimi:

d) të zgjedhë një Byro siç parashikohet ne Nenin VI;

e) të krijojë një Komitet Shkencor, siç parashikohet në Nenin VII; dhe

f) të vendosë mbi formatin dhe përmbajtjen e raporteve të Palëve për zbatimin e

Mirëkuptimit siç thuhet në Nenin VIII.

8. Në çdo sesion të tij të zakonshëm Takimi Palëve duhet:

- a) të shikojë vlerësimin shkencor të gjendjes së mbrojtjes së gjitarëve të zonës së Mirëkuptimit dhe vendbanimeve që janë të rëndësishëm për mbijetesën e tyre, si dhe faktorët që mund të ndikojnë në mënyrë të pafavorshme;
- b) të rishikojë progresin e bërë dhe vështirësitë e ndeshura në zbatimin e këtij Mirëkuptimi mbi bazën e raporteve të Palëve dhe të sekretariatit të Mirëkuptimit
- c) të bëjë rekomandime për Palët aty ku është të nevojshme ose e përshtatshme dhe të përshtasë veprime specifike për përmirësimin e efektivitetit të këtij Mirëkuptimi;
- d) të shqyrtojë dhe vendosë për ndonjë propozim për të ridryshuar, kur është e nevojshme, këtë Mirëkuptim;
- e) të miratojë një buxhet për periudhën tjetër financiare dhe të vendosë për çështje që lidhen me përgatitjet financiare për këtë Mirëkuptim.
- f) të rishikojë përgatitjet për Sekretariatit e Mirëkuptimit, njësitë ko-ordinuese dhe Komitetin Shkencor,
- g) të përshtasë një raport për komunikim tek Palët e këtij Mirëkuptimi dhe tek Konferenca e Palëve e Konventës,
- h) të bjerë dakort për kohën e përshtatshme dhe vendin e takimit tjetër, dhe
- p të lidhet me çështje të tjera që lidhen me zbatimin e këtij Mirëkuptimi.

Neni IV Sekretariati i Mirëkuptimit

Me vendim të Konferencës së Palëve të Konventës, një sekretariat për Mirëkuptimin do të krijohet brenda Sekretariatit të Konventës. Nëse Sekretariati Konventës nuk është në gjendje, që në çdo kohë, të kryejë këtë funksion, Takimi Palëve duhet të miratojë zgjidhje tjetër.

Funksionet e sekretariatit të Mirëkuptimit do të jenë:

- a) të përgatisë dhe shërbejë sesioneve të Takimit të Palëve;
- b) të lidhet dhe lehtësojë bashkëpunimin midis Palëve dhe Shteteve Pjesëmarrëse që nuk janë Palë, dhe organizmave ndërkombëtarë dhe kombëtarë aktivitetet e të cilave janë drejtpërdrejt ose indirekt me mbrojtjen e gjitarëve në zonën e Mirëkuptimit;

- c) të ndihmojë Palët në zbatimin e këtij Mirëkuptimi duke siguruar bashkëveprim midis nënrajoneve dhe me masat e marra sipas instrumentave të tjerë ndërkombëtarë në fuqi
- d) të ekzekutojë vendime që i caktohen nga Takimi i Palëve
- e) të terheqë vëmendjen e Takimit të Palëve për çështje që lidhen me këtë Mirëkuptim
- f) të paraqesë në çdo sesion të zakonshëm të Takimit të Palëve një raport mbi punën e sekretariatit të Mirëkuptimit, njësisë kordinuese, Byrosë, dhe Komitetit Shkencor, dhe mbi zbatimin e Mirëkuptimit të bazuar në informacionin e marrë nga Palët dhe burime të tjera;
- g) të administrojë buxhetin për këtë Mirëkuptim;
- h) të sigurojë informacion për përblikim e gjerë lidhur me Mirëkuptimin dhe objektivat e tij, dhe
- g) të kryejë funksione të tjera të caktuara për të nga ky Mirëkuptim ose nga Takimi i Palëve

3. Sekretariati i Mirëkuptimit, në konsultim me Komitetin Shkencor dhe njësitë Koordinuese, duhet të lehtësojë përgatitjen e udhëzimeve që përfshijnë *ndër të tjera*:

- a) reduktimin ose eliminimin, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe për qëllime të këtij; Mirëkuptimi të ndërhyrjeve të të pakthyeshme njëri – gjitar;
- b) mbrojtja e vendbanimeve dhe metodat e menaxhimit të burimeve natyrore që lidhen me gjitarët
- c) masat emergjente; dhe
- d) metodat e shpëtimit

Neni V **Njësitë Ko-ordinuese**

1. Funksionet e njësisë Ko-ordinuese nënrajonale do të jenë:

- a) të lehtësojë zbatimin në nënrajonet respektive të aktiviteteve të përmendura në Shtojcën 2 të këtij Mirëkuptimi, në përputhje me udhëzimet e Takimit të Palëve;
- b) grumbullimi dhe vlerësimi i informacionit që ndihmon objektivat dhe zbatimin e Mirëkuptimi dhe të sigurojë shpërndarjen e përshtatshme të këtij informacioni; dhe
- c) ti shërbejë takimeve të Komitetit Shkencor dhe të përgatisë një raport për komunikim në Takimin e Palëve nëpërmjet sekretariatit të Mirëkuptimit

Caktimi i njësisë Koordinuese dhe funksionet e tyre duhet të rishikohen kur është e përshtatshme, në çdo sesion të Takimit të Palëve.

2. Cdo njësi Kordinuese, në bashkëpunim me Komitetin Shkencor dhe sekretariatit e Mirëkuptimit duhet të lehtësojë përgatitjen e serive të publikimeve ndërkombëtarë që duhen rishikuar rregullisht, që përfshijnë:

a) raportet mbi gjendjen dhe të ardhmen e popullatave, si dhe mungesat në njohuritë shkencore

b) një drejtori nënrajonale e zonave të rëndësishme për gjitarët; dhe

c) një drejtori nënrajonale e autoriteteve kombëtare, qendrave të kërkimit dhe shpëtimit, shkencetarët dhe organizatat jo-qeveritare që lidhen me gjitarët.

Neni VI Byroja

1. Takimi i Palëve do të zgjedhë një byro që përbëhet nga Kryetari dhe Zëvendës/Kryetarët e Takimit të Palëve, dhe do të miratojë rregullat proceduriale për Byronë, siç propozohet nga sekretariati i Mirëkuptimit. Kryetari i Komitetit Shkencor do të ftohet të marrë pjesë si vëzhgues në takimet e Byrosë. Kur të jetë e nevojshme, sekretariati i Mirëkuptimit do të kryejë detyrat e sekretariatit.

2. Byroja do të:

a) sigurojë udhëzime të përgjithshme politike dhe drejtime operacionale dhe financiare për sekretariatit e Mirëkuptimit dhe njërive Ko-ordinuese lidhur me zbatimin dhe nxitjen e Mirëkuptimit;

b) të kryejë, midis sesioneve të Mbledhjes së Palëve, aktivitete të tilla të ndërmjetme të nevojshme ose të caktuara ndaj tij prej Konferencës së Palëve; dhe

c) përfaqësojë Palët anasjelltas Qeverinë e vendit pritës të sekretariatit të Mirëkuptimit dhe Takimit të Palëve, Depozituesin dhe organizata të tjera ndërkombëtare për çështje lidhur me këtë Mirëkuptim dhe sekretariatit tij.

3. Me kërkesë të Kryetarit, Byroja normalisht do të takohet një herë në vit me ftesë të sekretariatit të Mirëkuptimit, i cili do të njoftojë të gjitha Palët për datën, vendin dhe programin e takimeve të tilla.

4. Byroja duhet të paraqesë një raport për aktivitetet e saj në çdo sesion të Takimit të Palëve i cili do të shpëndahej të gjitha Palëve përpara sesionit nga sekretariati i Mirëkuptimit.

Neni VII

Komiteti Shkencor

1. Një Komitet Shkencor, i përbërë nga njërëz të kualifikuar si ekspertë të shkencës për mbrojtjen e gjitarëve, do të krijohet si organ këshillues për Takimin e Palëve. Takimi i Palëve do të besojë funksionet e Komitetit Shkencor një organizate ekzistuese në zonën e Mirëkuptimit që siguron një përfaqësim të barabartë nga shtrirja gjeografike.
2. Takimet e Komitetit Shkencor do të thirren nga sekretariati i Mirëkuptimit me kërkesë të Takimit të Palëve.
3. Komiteti Shkencor do të:
 - a) japë këshilla për Takimin e Palëve për çështje teknike dhe shkencore duke patur parasysh zbatimin e Mirëkuptimit, dhe për Palët ndërmjet sesioneve, nëse është e mundur, nëpërmjet njësisë Ko-ordinuese të nënrajonit në fjalë,
 - b) të këshillojë për udhëzimet e përmendura në Nenin IV, paragrafi 3, vlerësojë komentet e bëra në përputhje me Shtojcën 2 të këtij Mirëkuptimi dhe përgatisë rekomandime për Takimin e Palëve lidhur me ecurinë, përmbajtjen dhe zbatimin e tyre,
 - c) drejtojë vlerësime shkencore për gjendjen e mbrojtjes së popullatave të gjitarëve,
 - d) këshillojë për ecurinë dhe ko-ordinimit të programeve ndërkombëtare të kërkimit dhe monitorimit, dhe të bëjë rekomandime për Takimin e Palëve lidhur me kryerjen e kërkimeve të mëtejshme;
 - e) lehtësojë shkëmbimin e informacionit shkencor dhe teknikave të mbrojtjes;
 - f) përgatisë për çdo sesion të Takimit të Palëve një raport për aktivitetet e tij që duhet ti paraqiten sekretariatit të Mirëkuptimit jo më pak së 120 ditë përpara sesionit të Takimit të Palëve dhe që duhet ti shpërndahet të gjitha Palëve nga sekretariati i Mirëkuptimit;
 - g) japë këshilla kohore për përjashtimet e të cilave është informuar në përputhje me Nenin II, paragrafi 2 ; dhe
 - h) të kryejë, kur është e nevojshme, detyra të tjera të ngarkuara atij nga Takimi i Palëve.
4. Komiteti Shkencor, në konsultim me Byronë dhe njësitë Koordinuese respektive, mund të krijojë grupe pune kur është e nevojshme të kryejnë detyra specifike. Takimi i Palëve duhet të miratojë caktimin e një buxheti për këtë qëllim.

Neni VIII Komunikimi dhe Raportimi

Çdo Palë duhet:

a) të caktojë një pikë fokale për këtë Mirëkuptim dhe duhet ta komunikojë pa vonesë emrin, adresën dhe tel, fax, e-mail të pikës fokale tek sekretariati i Mirëkuptimit për njoftim të menjëhershëm për Palët e tjera dhe njësitë Ko-ordinuese; dhe

b) të përgatise për çdo sesion të zakonshëm të Takimit të Palëve, duke filluar nga sesioni i dytë, një raport mbi zbatimin e Mirëkuptimit prej saj duke ti përqëndruar në masat mbrojtëse dhe kërkimin shkencor e monitorimin që ka kryer. Formati i këtyre raporteve do të përcaktohet nga sesioni i parë i Takimit të Palëve dhe rishikohet kur është e nevojshme në sesionet e mëpasme. Cdo raport duhet të dorëzohet tek sekretariati i Mirëkuptimit jo më pak së 120 ditë përpara hapjes së sesionit të Takimit të Palëve për të cilin ai është përgatitur, dhe kopje duhet të shpërndahen Palëve të tjera nga sekretariati i Mirëkuptimit.

Neni IX Cështjet Financiare

1. Shkalla e kontributeve në buxhetin e këtij Mirëkuptimi do të përcaktohet nga Takimi i Palëve në sesionin e tij të parë. Organizatave rajonale për integrimin e ekonomik nuk do tu kërkohet të kontribojnë me shumë së 2,5% të kostove administrative.
2. Vendimet lidhur me buxhetin dhe ndryshimet në përqindjen e kontributeve kur shihen të nevojshme do të miratohen nga Takimi i Palëve me konsensus.
3. Takimi i Palëve mund të krijojë një fond shtesë mbrojtjeje nga kontributet vullnetare të Palëve ose nga burime të tjera me qëllim që të rrisë fondet për monitorimin, kërkimin, treininin dhe projektet e lidhura me mbrojtjen e gjitarëve.
4. Palët do të nxiten të paraqesin mbeshtetje teknike dhe financiare mbi baza dyPalëshe ose shumëPalëshe për ti asistuar Shteteve Pjesëmarrëse që janë vende në zhvillim ose vende me ekonomi në tranzicion për të zbatuar kushtet e këtij Mirëkuptimi.
5. Sekretariati i Mirëkuptimit do të kryejë periodikisht një rishikim të mekanizmave të mundshëm për sigurimin e burimeve shtesë, përfshirë këtu fonde dhe asistencë teknike, për zbatimin e këtij Mirëkuptimi, dhe do të raportojnë rezultatet në Takimin e Palëve.

Neni X Ndryshimi i Mirëkuptimit

1. Ky Mirëkuptim mund të ndryshohet në çdo sesion të zakonshëm ose jashtëzakonshëm të Takimit të Palëve.
2. Propozime për ndryshime të Mirëkuptimit mund të bëhen nga çdo Palë. Teksti i ndryshimeve të propozuara dhe arsyet për të duhet ti komunikohen sekretariatit të Mirëkuptimit jo më pak së 150 ditë përpara hapjes së sesionit. Sekretariati i Mirëkuptimit

duhet të dërgojë kopje të ndryshimeve tek Palët. Cdo koment për tekstin prej Palëve duhet ti komunikohet sekretariatit të Mirëkuptimit jo më pak së 60 ditë përpara hapjes së sesionit. Sekretariati duhet ti komunikojë Palëve, sa më parë pas ditës së fundit për dorëzimin e komenteve, të gjitha komentet e marra atë ditë.

3. Cdo shtojcë më tepër ose çdo ndryshim i Mirëkuptimit pa përmendur ndryshimin e shtojcave të tij duhet të miratohet prej 2/3 së Palëve që janë prezent dhe votojnë dhe do të hyjë në fuqi për ato Palë që e kanë pranuar atë në ditën e 30 pas datës kur 2/3 e Palëve të Mirëkuptimit në datën e pranimit të shtojcës tepër ose ndryshimit, kanë depozituar instrumentat e tyre të pranimit tek Depozituesi. Për çdo Palë që depoziton një instrument pranimi pas datës në të cilën 2/3 e Palëve kanë depozituar instrumentat e tyre të pranimit, shtojca tepër ose ndryshimi do të hyjë në fuqi ditën e 30 pas datës që depozitohet instrumenti i tij i pranimit.

4. Cdo ndryshim i shtojcës së Mirëkuptimit duhet të miratohet nga 2/3 e Palëve prezent dhe që votojnë dhe do të hyjë në fuqi për të gjitha Palët ditën e 150-të pas datës së miratimit të tij nga Takimi i Palëve, përveç për Palët që kanë shprehur rezervë në përputhje me paragrafin 5 të këtij Neni.

5. Gjatë periudhës prej 150 ditësh përmendur në pikës 4 të këtij Neni, çdo Palë mund të paraqesë një rezervë nëpërmjet një njoftimi të shkruar tek Depozituesi për një ndryshim të një aneksi të Mirëkuptimit. Një rezervë e tillë mund të tërhiqet me kërkesë të shkruar tek Depozituesi, dhe ndryshimi do të hyjë në fuqi për atë Palë ditën e 30-të pas datës së tërheqjes së rezervës.

Neni XI

Efekti i këtij Mirëkuptimi mbi Legjislacionin dhe Konventat Ndërkombëtare

1. Kushtet e këtij Mirëkuptimi nuk do të ndikojnë të drejtën e Palëve të mbajnë ose miratojnë masa me shtrënguese për mbrojtjen e gjitarëve dhe vendbanimeve të tyre, dhe as të drejtat ose detyrimet e çdo Palë që rrjedhin nga ndonjë traktat ekzistues, konventë ose mirëkuptim në të cilin ajo është Palë, përveç kur ushtrimi i këtyre të drejtave dhe detyrimeve rrezikon mbrojtjen e gjitarëve.

2. Palët duhet të zbatojnë këtë Mirëkuptim në mënyrë të vazhdueshme me të drejtat dhe detyrimet e tyre të caktuara nga ligji i detit.

Neni XII

Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

1. Cdo mosmarrveshje që mund të lindë midis dy ose më shumë Palëve lidhur me interpretimin ose aplikimin e kushteve të këtij Mirëkuptimi do të jetë subjekt i negociatave midis Palëve të përfshira në mosmarrveshje, ose ndërmjetësimit ose pajtimit prej një Palë të tretë nëse kjo është e pranueshme për Palët në fjalë.

2. Nëse mosmarrveshja nuk zgjidhte sipas Pikës I të këtij Neni, Palët me konsensus të

përbashkët paraqesin mosmarrveshjen tek zgjidhësi gjyqësor ose juridik. Palët që paraqesin mosmarrveshjen duhet ti binden vendimit gjyqësor ose juridik.

Neni XIII **Nënshkrimi, Ratifikimi, Pranimi, Aprovimi ose Pëlqimi**

Ky Mirëkuptim do të hapet për nënshkrim për çdo Shtet Pjesmarrës, pavarësisht së zonat nën juridiksionin e tij shtrihen ose jo në zonën e Mirëkuptimit, ose organizatë për integrimin ekonomik rajonal, kur të paktën një anëtar i saj është Shtet Pjesmarrës, ose për:

- a) nënshkrim pa rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose aprovimin; ose
- b) nënshkrimi me rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose aprovimin, ndjekur nga ratifikimi, pranimi ose aprovimi.

2. Ky Mirëkuptim do të jetë i hapur për nënshkrim në Monako deri në datën e hyrjes në fuqi të tij.

Ky Mirëkuptim do të jetë i hapur për pëlqim nga çdo Shtet Pjesmarrës ose organizatë për integrimin ekonomik rajonal të përmendur në pikën 1, me sipër, ne dhe pas datës së hyrjes në fuqi të Mirëkuptimit.

4. Instrumentat e ratifikimit, pranimit, aprovimit ose pëlqimit do të depozitohen tek Depozituesi.

Neni XIV **Hyrja në Fuqi**

1. Ky Mirëkuptim do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pas datës kur të paktën 7 Shtete bregdetare të zonës së Mirëkuptimit ose organizatave të integritit ekonomik rajonal, që përbëjnë të paktën 2 nga nënrajoni i Detit të Zi dhe të paktën 5 nga nënrajoni i Detit Mesdhe dhe zonës në kufi me Atlantikun, kanë nënshkruar pa rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose aprovimin, ose kanë depozituar instrumentat e tyre të ratifikimit, pranimit ose aprovimit në përputhje me Nenin XIII të këtij Mirëkuptimi.

2. Për çdo Shtet Pjesmarrës ose organizatë për integrimin ekonomik rajonal që ka:

- a) nënshkruar pa rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin apo aprovimin,
- b) ratifikuar, pranuar ose aprovuar; ose
- c) pëlqyer

ky Mirëkuptim pas datës kur numri i Shteteve Pjesmarrëse dhe organizatave për integrimin ekonomik rajonal i nevojshëm të lejojë hyrjen në fuqi e kanë nënshkruar atë pa

rezerva ose e kanë ratifikuar, pranuar ose aprovuar atë, ky Mirëkuptim do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë pas nënshkrimit pa rezerva, ose depozitimit, nga ai Shtet ose organizatë, të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, aprovimit ose pëlqimit.

Neni XV Rezervat

Kushtet e këtij Mirëkuptimi nuk do të jenë objekt i rezervave të përgjithshme. Sidoqoftë, një rezervë specifike mund të paraqitet nga çdo Shtet lidhur me një pjesë specifike të pakufizuar të ujrave të tij brendshme, në nënshkrimin pa rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose aprovimin ose, siç mund të jetë rasti në depozitimin e instrumentit të tij të ratifikimit, pranimi, aprovimit ose pëlqimit. Ky rezervim mund të terhiqet në çdo kohë nga Shteti i cili e paraqiti atë duke njoftuar me shkrim tek Depozituesi; Shteti në fjalë nuk do të detyrohet nga aplikimi i Mirëkuptimit në ujrat që janë objekt i rezervës deri në 30 ditë pas datës në të cilën rezerva është tërhequr.

NENI XVI Denoncimi

Cdo Palë mund të denoncojë këtë Mirëkuptim në çdo kohë me një njoftim të shkruar tek depozituesi. Denoncimi do të ketë efekt 12 muaj pas datës pasi Depozituesi ka marrë njoftimin.

Neni XVII Depozituesi

1. Originali i këtij Mirëkuptimi, në Arabisht, Anglisht, Frengjisht, Rusisht dhe Spanjisht, çdo version i qënë autentik, do të depozitohet tek Qeveria e Principatës së Monakos, e cila do të jetë Depozituesi. Depozituesi do të dergojë kopje të noterizuara të Mirëkuptimit tek të gjitha Shtetet dhe organizatat për integrimin ekonomik rajonal të cilësuar në Nenni XIII, pika 1, i këtij Mirëkuptimi, dhe tek sekretariati i Mirëkuptimit pas krijimit të tij.

2. Sapo ky Mirëkuptim të hyjë në fuqi, një kopje e noterizuar do të dorëzohet nga Depozituesi tek Sekretariati i Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe botim në përputhje me Nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

3. Depozituesi duhet të informojë të gjitha Shtetet dhe organizatat për integrimin ekonomik rajonal që kanë nënshkruar ose pëlqyer Mirëkuptimin dhe sekretariatit e Mirëkuptimit, për:

a) çdo nënshkrim;

b) çdo depozitim të instrumentit të ratifikimit, pranimi, aprovimit ose pëlqimit;

c) datën e hyrjes në fuqi të këtij Mirëkuptimi dhe çdo shtojcë tjetër si dhe ndryshimeve të

Mirëkuptimit ose shtojcave të tij;

d) çdo rezervë për ndonjë shtojcë tjetër ose një ndryshim i një shtojcë;

e) çdo njoftim për tërheqjen e një rezerve; dhe

f) çdo njoftim i denoncimit të këtij Mirëkuptimi.

Depozituesi duhet tu dergojë të gjitha Shteteve dhe organizatave për integrimin ekonomik rajonal që kanë nënshkruar ose pëlqyer këtë Mirëkuptim dhe sekretariatit të Mirëkuptimit, tekstin e çdo rezerve, çdo shtojcë tjetër dhe çdo ndryshim të Mirëkuptimit dhe shtojcave të tij.

Në prani nënshkruarit, të autorizuar për këtë qëllim firmosen këtë Mirëkuptim. Bërë në Monako në ditën e njëzet e katërt të Nëntorit 1996.

SHTOJCA I

LISTA GJITARËVE TË DETIT TË ZI PËR TË CILET APLIKOHET KY MIRËKUPTIM

PHOCOENIDAE

Phocoena phocoena

DELPNINIDAE

Tursiops trunatus

Delphinus delphis

LISTA E GJITARËVE TË DETIT MESDHE, DHE ZONAVE NE KUFI ME ATLANTIKNN PËR TË CILET APLIKOHET KY MIRËKUPTIM

PHOCOENIDAE

Phocoena phocoena

DELPHINIDAE

Steno bredanënsis

Grampus griseus

Tursiops trunatus

Sterrella coeruleoalba

Delphinus delphis

Pseudorca crassidens

Orcinus orca

Globicephala melas

ZIPHIIDAE

Mesoplodon densirostris

Ziphius cavirostris

PHYSETERIDAE

Physeter macrocephalus

KOGIIDAE

Kogia simus

BALAENIDAE

Eubalaena glacialis

BALAENOPTERIDAE

Balaenoptera acutorostrata

Balaenoptera borealis

Balaenoptera physalus

Megaptera novaeangliae

Ky Mirëkuptim mund të aplikohet dhe për gjitarë të tjerë që nuk janë vendosur akoma në listë, të cilët kalojnë në zonën e Mirëkuptimit aksidentalisht ose rastësisht.

SHTOJCA II

PLANI I MBROJTJES

Palët duhet të ndërmarrin, me maksimumin e kapaciteteve të tyre ekonomike, teknike, dhe shkencore, masat e përmendura më poshtë për mbrojtjen e gjitarëve, duke i dhënë prioritet mbrojtjes së atyre specieve ose popullatave të përcaktuara nga Komiteti Shkencor që janë më pak të mbrojtura, dhe ndërmarrin kërkime në zonat ose për speciet për të cilat ka pak të dhëna.

1. Përshtatja dhe forcimi i legjislacionit kombëtar

Palët në këtë Mirëkuptim duhet të përshtasin masat e nevojshme ligjore, rregullatore ose administrative për ti dhënë mbrojtje të plotë gjitarëve në ujrat në territorin dhe/ose juridiksionin e tyre dhe jashtë këtyre ujrave në territore jashtë kufijve kombëtarë ose të regjistruar në territorin e tyre të përfshirë në aktivitete që mund të ndikojnë në mbrojtjen e gjitarëve. Për këtë, Palët duhet:

a) të përgatisin dhe zbatojnë masa për minimizimin e efekteve negative të peshkimit për mbrojtjen e gjitarëve. Në veçanti, asnjë anije nuk do të lejohet të mbajë në bord, ose të përdorë për peshkim, një ose më shumë rrjeta, gjatesia individuale ose totale e të cilave është më shumë së 2,5 km,

b) të përgatisë ose ndryshojë rregulla me qëllim parandalimin e hedhjes ose lënies pa lidhur të pajisjeve të peshkimit, dhe të kërkojë lëshimin e menjëhershëm të gjitarëve të kapur aksidentalisht në pajisjet e peshkimit në kushte që sigurojnë mbijetesën e tyre;

c) të kërkojnë kryerjen e vlerësimit të ndikimit me qëllim sigurimin e bazave për lejimin ose ndalimin e vazhdimin në të tashmen ose të ardhmen të aktiviteteve që mund të ndikojnë në gjitarët ose vendbanimin e tyre në zonën e Mirëkuptimit, përfshirë peshkimin, kërkimet dhe shfrytëzimet në det, sportet ujore, turizmin dhe shikimin e gjitarëve, si dhe vendosja e kushteve mbi të cilat do të zhvillohen këto aktivitete;

d) të rregullojë shkarkimin në det dhe të përshtasë brenda rrjetit të instrumentave ligjore të përshtatshëm standarte strikte për, ndotësat që mendohet së kanë efekte negative mbi gjitarët; dhe

e) të përpiqen të forcojnë ose krijojnë institucione kombëtare me qëllim zbatimin e mëtejshëm të Mirëkuptimit.

2. Vlerësimi dhe menaxhimi i raporteve njëri - gjitarë

Palët në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare përkatëse, duhet të grumbullojnë dhe analizojnë të dhënat për raportet direkte dhe indirekte midis njërëzve dhe gjitarëve në raport *ndër të tjera* me peshkimin, aktivitetet industriale dhe turistike, dhe ndotjen e tokës dhe detit. Kur është e nevojshme, Palët duhet të ndërmarrin masa ndreqëse dhe të

përgatiten udhezime dhe/ose kode drejtimi për të rregulluar ose menazhuar aktivitete të tilla.

3. Mbrojtja e vendbanimit

Palët duhet të përpiqen të vendosin dhe menaxhojnë zona veçanërisht të mbrojtura për gjitarët që i korrespondojnë zonave që shërbejnë si vendbanime të gjitarëve dhe/ose që sigurojnë burime të rëndësishme ushqimore për to. Të tilla zona veçanërisht të mbrojtura duhet të krijohen në kuadër të Konventës për Mbrojtjen e Detit Mesdhe kundërndotjes, 1976, dhe protokolleve përkatëse të saj, ose në kuadrin e instrumentave të tjerë të përshtatshëm.

4. Kërkimi dhe monitorimi

Palët duhet të ndërmarrin kërkime të ko-ordinuara, të bashkërenduara për gjitarët dhe të lehtësojnë zhvillimin e teknikave të reja për të Shtuar mbrojtjen e tyre. Palët në veçanti duhet

- a) të monitorojnë gjendjen dhe drejtimit për speciet e përfshira në këtë Mirëkuptim veçanërisht atyre në zonat e njohura pak, ose specieve për të cilat Pak të dhëna janë të njohura, më qëllim lehtësimin e realizimit të masave mbrojtëse;
- b) të bashkëpunojnë për të përcaktuar rrugët e migrimit dhe zonat e shumëzimit dhe ushqimit të specieve të këtij Mirëkuptimi me qëllim përcaktimin e zonave ku aktivitetet njëzëre janë të nevojshme të rregullohen;
- c) të vlerësojnë kërkesat për ushqim të specieve që përfshihen në këtë Mirëkuptim dhe përshtasin rregulla dhe teknika peshkimi për këtë qëllim;
- d) të zhvillojnë programe kërkimi sistematike për kafshët e ngordhura, të dala në breg, të plagosura ose të sëmura për të përcaktuar raportet kryesore me aktivitetet njëzëre dhe të identifikohen rreziqet aktuale dhe potenciale; dhe
- e) të lehtësojnë zhvillimin e teknikave pasive akustike për monitorimin e popullatave të gjitarëve

5. Forcimi i mundësive, grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit, trenimi dhe edukimi

Duke marrë parasysh, nevojat e ndryshme dhe shkaqet e zhvillimit të Shteteve Pjesëmarrëse, Palët duhet t'i japin prioritet forcimit të mundësive me qëllim zhvillimin e ekspertizës së nevojshme për zbatimin e këtij Mirëkuptimi. Palët duhet të bashkëpunojnë për të krijuar mjete të përbashkëta për grumbullimin dhe shpërndarjen e infomacionit për gjitarët dhe të organizojnë kurse trenimi dhe programe edukimi. Veprime të tilla duhet të kryhen në bashkërendim në nivel nënrajonal dhe të Mirëkuptimit, të mbështetura nga sekretariati i Mirëkuptimit, njësitë Ko-ordinuese dhe Komiteti Shkencor dhe të realizohen

ne bashkëveprim me institucionet ose organizatat ndërkombëtare kompetente. Rezultatet duhet tu bëhen të ditura të gjitha Palëve. Në veçanti, Palët duhet të bashkëpunojnë për:

- a) krijimin e sistemeve, grumbullimit të dhënave për vëzhgim mbi kapjet aksidentale, nxjerrjet në breg, dhe fenomene të tjera të lidhura me gjitarët,
- b) përgatitjen e listave të autoriteteve kombëtare, qendrat e kërkimit dhe shpëtimit, shkencëtarët dhe organizatat jo-qeveritare që lidhen me gjitarët;
- c) përgatitjen e një drejtorie për zonat ekzistuese të mbrojtura ose të menaxhuara që mund të ndihmojnë për mbrojtjen e gjitarëve dhe të zonave detare me rëndësi të madhe për mbrojtjen e gjitarëve,
- d) përgatitjen e një drejtorie për legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar lidhur me gjitarët,
- e) vendosin, kur është mundur një bankë të dhënash rajonale ose nënrajonale për ruajtjen e informacionit të grumbulluar sipas paragrafeve a) deri d) më sipër;
- f) përgatitjen e një buletini infomativ rajonal ose nënrajon mbi aktivitetin e mbrojtjes së gjitarëve ose të kontribuojnë në një publikim ekzistues që i shërben të të njëjtit qëllim;
- g) përgatisin udhëzime informuese, ndërgjegjësuese dhe identifikuese për tja shpërndare përdoruesve të detit.
- h) përgatisin, mbi bazën njohurive rajonale, një sintezë të rekomandimeve veterinarë për shpëtimin gjitarëve; dhe
- i) të zhvillojnë dhe zbatojnë programe trainimi për teknikat mbrojtëse, në veçanti mbi vëzhgimin, qarkullimin, transportin dhe teknikat e ndihmës së parë, dhe përgjigjen ndaj situatave urgjente.

6. Përgjigja ndaj situatave emergjente

Palët në bashkëpunim me njëra tjetrën dhe ku është e nevojshme dhe e mundur, duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë masa emergjente për gjitarët që përfshihen në këtë Mirëkuptim kur në raste të veçanta shfaqen kushte të pafavorshme ose të rrezikshme. Në veçanti, Palët duhet:

- a) të përgatisin, në bashkëpunim me organet kompetente, plane emergjente për tu zbatuar në rast të rrezikimit të gjitarëve në zonën e Mirëkuptimit, të tilla si rastet e ndotjeve madhore, lëniet në bregdet; dhe
- b) vlerësimi i kapaciteteve të nevojshme për operacionet e shpëtimit për gjitarët e plagosur ose të semurë; dhe

c) përgatisin një kod drejtimi që do të udhezojë funksionimin e qendrave ose laboratoreve të përfshira me këtë punë.

Në rastin e një situatë emergjente që kërkon përshtatjen e masave imediate për të shmangur degjenerimin e statusit të mbrojtjes të një ose më shumë popullatave të gjitarëve, një Palë mund të kërkojë njësisë Ko-ordinuese përkatëse të këshillojë Palët e tjera në fjalë, me qëllim vendosjen e një mekanizmi për të dhënë mbrojtje të shpejtë popullatave të identifikuara si subjekt i një rreziku të veçantë të pakthyeshëm.

MIRËKUPTIMI PËR MBROJTJEN E LAKURIQEVE NE EUROPE

Palët,

Duke kujtuar Konventën për Mbrojtjen e specieve Shtegtuese të Kafshëve të Egra e hapur për nënshkrim në Bon më 23 Qershor 1979;

Duke ditur gjendjen e pafavorshme mbrojtëse të lakuriqëve në Europe dhe vendet Pjesëmarrëse jo Evropiane dhe veçanërisht rrezikun serioz ndaj tyre prej degradimit të vendbanimeve. Shqetësimit të vendeve të pushimit dhe disa pesticideve;

Të ndërgjegjshëm që rreziqet që ndeshin lakuriqët në Europë dhe Vendet Pjesëmarrëse jo Evropiane janë të zakonshme për speciet shtegtuese dhe jo shtegëtuese dhe vendet e pushimit shpesh përdoren si nga speciet shtegtuese ashtu edhe jo shtegtuese.

Duke kujtuar që takimi i Parë i Konferencës së Palëve të Konventës për Mbrojtjen e Specieve Shtegtuese të Kafshëve të Egra mbajtur në Bon në tetor 1985 ranë dakort të shtojnë speciet Evropiane të CHIROPTERA (Rhinolophidae dhe Vespertilionidae) në Shtojcën II të Konventës dhe udhëzoi Sekretariatit e Konventës për të masat e duhura për përgatitjen e një Mirëkuptimi për këto specie.

Të ndërgjegjshëm që përgatitja e një Mirëkuptimi për këto specie do të ndihmojë shumë në mbrojtjen e lakuriqëve në Evrope

Ranë dakort si vijon:

NENI I

Shtrirja dhe Interpretimi

Për qëllimet e këtij Mirëkuptimi:

(a) "Konventë" kuptohet "Konventa për Mbrojtjen e Specieve Shtegtuese të kafshëve të Egra" (Bon 1979)

(b) "Lakuriqë" kuptohen popullatat Evropiane të CHIROPTERA (Rhinolophidae dhe Vespertilionidae) që ndodhen në Europë dhe Shtetet Pjesëmarrëse jo Evropiane;

(c) "Shtetet Pjesëmarrëse" kuptohet çdo Shtet (është ose jo Palë në Konventë që ushtron juridikson në ndonjë zonë të shtrirjes së specieve që përfshihen në këtë Mirëkuptim; Palët

(d) Organizatë Rajonale për Integrimin Ekonomik kuptohet një organizatë që përbehet nga Shtete sovraane për të cilën aplikohet ky Mirëkuptim dhe që ka kompetencë lidhur me çështjet që mbulohen nga ky Mirëkuptim dhe është autorizuar, në përputhje me

procedurat e saj të brendshme , të nënshkruajë, ratifikojë, pranojë, aprovojë ose pëlqejë këtë Mirëkuptim;

(e) "Palë" kuptohen, dhe nëse pëmbajtja tregon ndryshe, Palët në këtë Mirëkuptim;

(f) "Në Europë" kuptohet kontinenti i Europës.

NENI II

Kushte të Përgjithshme

1. Ky Mirëkuptim është një MIRËKUPTIM sipas kuptimit të paragrafit 3 të Nenit IV të Konventës.
2. Kushtet e këtij Mirëkuptimi nuk do të shmangin Palët nga detyrimet prej çdo traktati ekzistues, konventë ose mirëkuptimi.
3. Cdo Palë në këtë Mirëkuptim duhet të caktojë një ose më shumë autoritete kompetente, të cilave duhet tu caktojë përgjegjësitë për zbatimin e këtij Mirëkuptimi. Ajo duhet të komunikojë emrin dhe adresën e Institucionit ose institucioneve të tij tek Palët e tjera të këtij Mirëkuptimi.
4. Mbështetja financiare dhe administrative për këtë Mirëkuptim do të përcaktohet nga Palët e tij në konsultim me Palët e Konventës.

NENI III

Detyrimet Kryesore

1. Cdo Palë duhet të ndalojë kapjen e qëllimshme, mbajtjen ose vrasjen e lakuriqëve përveç rastëve me leje nga autoriteti kompetent.
2. Cdo Palë duhet të identifikojë ato zona brenda sipërfaqes nën juridiksionin e saj të cilat janë të rëndësishme për mbrojtjen, përfshirë strehimin dhe mbrojtjen e lakuriqëve. Ato duhet që, duke marrë parasysh konsideratat e nevojshme ekonomike dhe sociale, të mbrojnë këto zona nga dëmtimi ose shqetësimi. Cdo Palë duhet të përpiqet të identifikojë dhe mbrojë zonat e ushqimit të lakuriqëve nga dëmtimi ose shqetësimi.
3. Kur caktohen vendbanimet për tu mbrojtur për qëllim mbrojtje të përgjithshme çdo Palë duhet ti japë rëndësinë e duhur vendbanimeve të rëndësishme për lakuriqët.
4. Cdo Palë duhet të marrë masat e duhura për të nxitur mbrojtjen e lakuriqëve dhe duhet të rrisë ndërgjegjen e publikut për rëndësinë e mbrojtjes së lakuriqëve.
5. Cdo Palë duhet ti caktojë një institucioni të përshtatshëm përgjegjës për të dhënë këshilla për mbrojtjen dhe menaxhimin e lakuriqëve brenda territorit të tij veçanërisht për lakuriqët që strehohen në ndërtesa. Palët duhet të shkëmbejnë informacion për

eksperiencat e tyre për këtë çështje.

6. Cdo Palë duhet të ndërrarrë veprime shtesë kur e sheh të nevojshme të shpëtojë popullatat e lakuriqëve që ajo i ka përcaktuar si të rrezikuara dhe duhet të raportojë sipas Nenit IV mbi veprimin e marrë.

7. Cdo Palë duhet që kur është e përshtatshme, të nxisë programe kërkimi lidhur me mbrojtjen dhe menaxhimin e lakuriqëve. Palët duhet të konsultohen me njëra-tjetrën për këto programe kërkimi, dhe duhet të përpiqen të ko-ordinojnë programet e kërkimit dhe mbrojtjes.

8. Cdo Palë duhet që kur është e përshtatshme të marrë parasysh efektet potenciale të pesticideve mbi lakuriqët, kur vlerësohet pesticidet në to përdoren, dhe duhet të përpiqen të zëvendësojnë kimikatet për trajtimin e drurit të cilat janë shumë toksike për lakuriqët me trajtime më të sigurta.

NENI IV

Zbatimi Kombëtar

1. Cdo Palë duhet të përshtasë dhe zbatojë masat ligjore dhe administrative kur është e nevojshme me qëllim zbatimin e këtij Mirëkuptimi.

2. Kushtet e këtij Mirëkuptimi nuk duhet të ndikojnë në të drejtën e Palëve për të miratuar masa strikte për mbrojtjen e lakuriqëve.

NENI V

Takimi i Palëve

1. Duhet të organizohen takime periodike të Palëve të këtij Mirëkuptimi. Qeveria e Mbreterisë së Bashkuar duhet të organizojë takimin e parë të Palëve për këtë Mirëkuptim jo më vonë së 3 vjet pas datës së hyrjes në fuqi të Mirëkuptimit. Palët e këtij Mirëkuptimi duhet të miratojnë rregulla proceduriale për takimet e tyre dhe rregullat financiare, përfshirë dhe buxhetin dhe shkallën e kontributeve për periudhën tjetër financiare. Këto rregulla duhet të miratohen nga 2/3 e Palëve që janë prezent dhe që votojnë. Vendimet e marra sipas rregullave financiare do të kërkojnë 3/4 e Palëve prezent dhe që votojnë.

2. Në takimet e Palëve ;mund të krijohen grupe shkencore dhe të tjera siç mund të shihet e nevojshme.

3. Cdo Shtet Pjës-marrës ose Organizatë Rajonale për Integrimin Ekonomik që nuk është Palë në këtë Mirëkuptim, Sekretariati i Konventës, Këshilli i Europës në cilësinë e Sekretariatit të Konventës për Mbrojtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror të Europës dhe organizata të njëjta ndër-qeveritare mund të përfaqësohen si vëzhgues në takimet e Palëve. Cdo agjenci ose organizëm teknikisht i kualifikuar në

mbrojtjen dhe menaxhimin e lakuriqëve mund të përfaqësohet me vëzhgues në takimet e Palëve nëse të paktën 1/3 e Palëve paraqet objeksion. Vetëm Palët mund të votojnë në takimet e Palëve.

4. Përveç së e thuhet në Paragrafin 5 më poshtë, çdo Palë në këtë Mirëkuptim do të ketë 1 votë.

5. Organizatat për Integrimin Ekonomik Rajonal që janë Palë në këtë Mirëkuptim duhet që, për çështje brenda kompetencave të tyre, të ushtrojnë të drejtën të votojnë me një numer votash të barabartë me numrin e Shteteve të tyre anëtare që janë Palë në Mirëkuptim dhe janë prezent në kohën e votimit. Një organizatë Rajonale për Integrimin Ekonomik nuk do të ketë të drejtë votë nëse Shtetet e saj anëtare votojnë dhe anasjelltas.

NENI VI

Raportet për Zbatimin

Cdo Palë duhet të paraqesë në çdo takim Palësh një raport të fundit për zbatimin e këtij Mirëkuptimi. Ajo duhet ta dergojë raportin tek Palët jo më pak së 90 ditë përpara hapjes së takimit të zakonshëm.

Neni VII

Ndryshim i Mirëkuptimit

1. Ky Mirëkuptim mund të ndryshohet në çdo takim të Palëve.
2. Propozime për ndryshime mund të bëhen nga çdo Palë.
3. Teksti i çdo ndryshmi të propozuar dhe arsyet për këtë duhet ti komunikohen Depozituesit të paktën 90 ditë përpara hapjes së takimit. Depozituesi duhet të transmetojë menjëherë kopje tek Palët.
4. Ndryshimet duhet të miratohen nga 2/3 e Palëve që janë prezent dhe votojnë dhe do të hynë në fuqi për ato Palë që i kanë pranuar ato 60 ditë pas depozitimit të instrumentit të pestë të pranimit të ndryshimit tek Depozituesi. Ato do të hynë në fuqi për një Palë 30 ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të pranimit të ndryshimit tek Depozituesi.

Neni VIII

Rezervat

Kushtet e këtij Mirëkuptimi nuk do të jenë objekt i rezervave të përgjithshme. Sidoqoftë, një Shtet Pjesëmarres ose Organizatë për Integrimin Ekonomik Rajonal mund që, pasi të bëhet Palë sipas Nenit X ose XI, të paraqesë një rezervë specifike lidhur me çdo specie të veçantë të lakuriqëve.

NENI IX

Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

Cdo mosmarrveshje që mund të lindin midis Palëve lidhur me interpretimin ose aplikimin e kushteve të këtij Mirëkuptimi do të jetë objekt i bisedimeve midis Palëve të përfshira në Mosmarrveshje

NENI X

Nënshkrimi, Ratifikimi, Pranimi dhe Aprovimi

Ky Mirëkuptim do të jetë i hapur për nënshkrim nga Shtetet Pjesëmarrëse ose Organizatat Për Integrimin Ekonomik Rajonal të cilat mund të bëhen Palë ose:

- (a) duke e nënshkruar pa rezerva lidhur me ratifikimin pranimin ose aprovimin, ose
- (b) duke e nënshkruar me rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose aprovimin, ndjekur nga ratifikimi, pranimi ose aprovimi.

Instrumentat e ratifikimit, pranimin ose aprovimit duhet të depozitohen tek Depozituesi.

Ky Mirëkuptim do të jetë i hapur për nënshkrim deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij Mirëkuptimi.

NENI XI

Pranimi

Ky Mirëkuptim do të jetë i hapur për pranim për Shtetet Pjesëmarrëse ose Organizatat për Integrimin Ekonomik Rajonal pas datës së hyrjes në fuqi të Mirëkuptimit. Instrumentat e pranimin duhet të depozitohen tek Depozituesi.

NENI XII

Hyrja në Fuqi

Ky Mirëkuptim do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë pas datës në të cilën pesë Shtete Pjesëmarrëse janë bërë Palë sipas Nenit X. Ai do të hyjë në forcë për një Shtet që e ka nënshkruar ose pranuar në ditën e tridhjetë pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimin, aprovimit ose Pëlqimit.

NENI XIII

Denoncimi dhe Përfundimi

Cdo Palë mund të denoncojë këtë Mirëkuptim në formë të shkruar tek Depozituesi në çdo kohë. Denoncimi do të bëhet efektiv 12 muaj pas datës kur Depozituesi ka marrë njoftimin. Mirëkuptimi do të jetë në fuqi të paktën për 10 vjet dhe do të përfundojë në datën kur mbetën të paktën 5 shtete Palë.

NENI XIV

Depozituesi

Origjinali i Mirëkuptimit në Angjisht, Frengjisht dhe Gjermanisht, çdo variant të jetë i njëjtë do të depozitohet tek Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, e cila do të jetë Depozituesi dhe do ti transmetojnë kopje të noterizuara të gjitha Shteteve dhe çdo Organizate Rajonale për Inte-rimin Ekonomik që ka nënshkruar Mirëkuptimin ose depozituar instrumentat e ratifikimit, pranimit aprovimit ose pëlqimit.

Depozituesi duhet të infomojë të gjitha Shtetet Pjesmarrëse dhe organizatat Rajonale për Integrimin Ekonomik për nënshkrimet, depozitimin e instrumentave të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose pëlqimit, hyrjen në fuqi të këtij Mirëkuptimi, ndryshimet, rezervat dhe njoftimet e denoncimit.